

KONTRATA SOCIALE FIER

RAPORT MBI MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË PRIORITETEVE SHTATOR 2021-SHTATOR 2022

Viti i III-të i monitorimit

PËRGATITUR NGA:
QENDRA "EPOKA E RE"

POP – PËRBALLJA E OFERTAVE POLITIKE

Shtator 2021 – Shtator 2022

Ky raport vlerëson progresin e bërë në realizimin e prioriteteve të kontratës sociale për periudhën Shtator 2021 – Shtator 2022, referuar edhe rezultateve të monitorimit të një viti më parë.

Tabela e Përmbajtjes

| | |
|---|------------|
| SHKURTIME | 4 |
| FALENDERIME..... | 5 |
| HYRJE..... | 6 |
| PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE..... | 10 |
| GJETJET | 11 |
| KONTRATAT SOCIALE BASHKIA FIER | 122 |
| SITUATA E PRIORITETEVE 2021 - 2022 | 124 |
| KËSHILLI BASHKIAK FIER | 15 |
| MBLEDHJET E KËSHILLIT TË BASHKISË FIER | 177 |
| GJETJE NGA BASHKIA FIER | 18 |
| GJETJE NGA KOMUNITETI..... | 28 |
| ANALIZA E PRIORITETEVE | 32 |
| PRIORITET 1: TRANSPARENCA..... | 32 |
| PRIORITET 2 : INFRASTRUKTURA | 33 |
| PRIORITET 3: SHËRBIMET SOCIALE | 34 |
| PRIORITET 4: VËMENDJE NDAJ TË RINJVE | 34 |
| PRIORITET 5: VËMENDJE NDAJ FËMIJËVE | 35 |
| REKOMANDIME | 36 |
| ANEKSE | 38 |
| ANEKS 1: | 38 |
| ANEKS 2: | 47 |
| ANEKS 3: | 48 |

Shkurtime

| | |
|-------------------------------|--|
| BF | Bashkia Fier |
| NJA | Njësi Administrative |
| KB | Këshilli Bashkiak |
| VKB | Vendim i Këshillit Bashkiak |
| VKM | Vendim i Këshillit të Ministratave |
| URB | Zonat Urbane |
| RUR | Zonat Rurale |
| PAK | Personat me aftësi të kufizuar |
| ZK | Zonë Kadastrale |
| PBA | Buxheti Afat - Mesëm |
| PRP | Plani Rrugor për Pasaportën |
| PVMIM | Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve |
| POP | Përballja e Ofertave Politike |
| OSHC | Organizata e Shoqërisë Civile |
| COVID-19 | Koronavirusi Sars – kovid |
| Kontrata Sociale ¹ | Me prioritete të përzgjedhura nga komuniteti në vitin 2019 |
| | |

¹ <https://popnetwork.al/fier-kontrata-sociale/>

Falenderime

Puna për realizimin e këtij dokumenti ka qenë e madhe dhe e shtrirë në kohë. Është dashur një bashkëpunim i ngushtë mes qendrës epoka e Re, projektit POP, të rinjve aktiv dhe përfaqësuesve të qeverisjes vendore Fier. Rëndësi ka cdo element i renditur në këtë pjesë falenderuese, por ajo që kërkon më shumë vlerësim është vullneti për të bashkëpunuar dhe koordinuar punët, ndërhyrjet dhe informimin. Për këtë arsye falenderimi i parë është për Bashkinë dhe Këshillin e Bashkisë Fier. Falenderim të vecantë për komunitetn e Fierit në të gjithë territorin e bashkisë, të cilët pranuan të bëheshin pjesë e intervistave/fokus grupeve tona, të rinjve, mësuesve, grupeve të ndryshme të interesit.

Faleminderit të rinjve vullnetarë të qendrës Epoka e Re, të cilët kanë qenë shumë aktiv gjatë kësaj periudhe dhe mjaft të motivuar për të monitoruar të gjithë aktivitetin e Këshillit Bashkiak Fier dhe mbikqyrur progresin premtimeve të Kontratës Sociale POP – 2019 nga ana e Bashkisë Fier.

Gjithashtu dëshirojmë të falenderojmë ***Olof Palme International center*** dhe ***NED –National Endowment for Democracy*** për ndihmën teknike e financiare, pa të cilët do të ishte e pamundur të hartoheshin raport dhe të realizoheshin aktivitete të ndryshme nga Rrjeti POP².

² <https://popnetwork.al/rreth-projektit/>

Hyrje

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët, si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë vendore, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Gjatë vitit 2019 janë hartuar kontratat sociale për 9 bashki (Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier, Vlorë, Kamëz, Pogradec dhe Pukë), ndërsa tre bashki të reja u bënë pjesë e këtij procesi në vitin 2021, përmes replikimit të procesit edhe në bashkitë e Elbasanit, Vau i Dejës dhe Korçë duke e çuar në 12 numrin e bashkive nën monitorimin e organizatave të shoqërisë civile anëtare të rrjetit POP. Gjatë periudhës shtator 2021-2022 për të tretin vit me rradhë, rrjeti POP monitoroi zbatimin e tyre përmes dy projekteve që shkrihen te njëri – tjetri të financuara nga Olof Plame International Centre (OPIC) dhe National Endowment for Democracy (NED).

Ky është viti i tretë i monitorimit të punës së pushtetit vendor për përfshirjen e prioriteteve të qytetarëve dhe përmbushjen e Kontratës Sociale.

Kontrata Sociale në Fier³ përmban 5 prioritete që qytetarët e Fierit identifikuan në zgjedhjet lokale të 2019. Qendra “Epoka e Re”, synoi të krijojë dhe promovojë mekanizma qytetarë në funksion të përmirësimit të demokracisë lokale, duke angazhuar qytetarët, partitë politike, kandidatët për deputetë në zgjedhjet parlamentare të 2021, stafin e Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak të dialogojnë dhe të punojnë për realizimin e prioriteteve të Kontratës Sociale. Qendra Epoka e Re mundësoi vlerësimin dhe monitorimin e performancës së administratës lokale dhe të zgjedhurve vendorë duke promovuar dialog dhe bashkëpunim në nivel vendor. Në Bashkinë Fier, Kontrata Sociale bëri që komuniteti të ketë një mjet për të mbajtur stafin e bashkisë dhe Këshillin e Bashkiak përgjegjës për adresimin e tyre.

Faza e parë e kësaj nisme konsistonte në konsolidimin e saj me Qeverisjen vendore, njohjen me prioritetet e Kontratës Sociale⁴, deklarimin publik të saj me aktorët kryesorë vendore. Kjo periudhë përfshin procesin e monitorimit të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, të zbatimit të prioriteteve të kontratës sociale, të forcimit të marrëdhënieve midis qytetarëve, POP dhe aktorëve të tjerë në shoqëri. Pjesë e rëndësishme e saj ishte raportimi dhe veshja me përgjegjësi e drejtuesve në nivelin lokal për të përmbushur kontratën sociale.

Raporti i vitit të parë⁵ monitorues dhe raporti i vitit të dytë⁶ monitorues janë ndarë gjerësisht me përfaqësues të bashkisë Fier si edhe me qytetarët duke analizuar arritjet, por edhe punën që duhet bërë për përmbushjen e atyre prioriteteve që janë adresuar pak, ose aspak dhe kanë nevojë për një vëmendje më të shtuar të pushtetit vendor.

³ <https://popnetwork.al/wp-content/uploads/2019/06/POP-2019-Fier-Kontrata-Sociale.pdf>

⁴ https://popnetwork.al/wp-content/uploads/2020/11/Raporti_POP_Bashkia_Fier.pdf

⁵ <https://popnetwork.al/raporti-nje-vjecar-kontrata-sociale-bashkia-fier/>

⁶ https://popnetwork.al/wp-content/uploads/2022/01/Raporti-POP_Bashkia-Fier.pdf

Për të mbërritur në vitin e tretë të monitorimit⁷, gjatë vitit 2022, projekti vazhdoi me “Kontrata Sociale si mjet efektiv për pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje në nivel vendor dhe transparenca”, duke vijuar monitorimin dhe bashkëpunimin mes aktorëve kryesorë për përmbushjen e prioriteteve të qytetarëve.

Ky raport vlerëson progresin e bërë në realizimin e prioriteteve të Kontratës Sociale për periudhën Shtator 2021 – Shtator 2022.

Gjatë vitit të tretë të monitorimit Organizata kishte si qëllim:

- Të monitorojë Këshillin Bashkiak dhe veprimtarinë e Bashkisë për marrjen dhe zbatimin e masave në kuadër të adresimit të prioriteteve të Kontratës Sociale;
- Të monitorojë Këshillin Bashkiak dhe veprimtarinë e Bashkisë;
- Të raportojë gjetjet dhe rekomandimet;
- Të llobojë dhe advokojë për përmbushjen e prioriteteve të qytetarëve, sidomos në kuadër të dimensionit social, transparencës dhe llogaridhënies;
- Të përdorë gjetjet e Raportit studimor “Informimi, Njoftimi dhe Konsultimi Publik nga pushteti vendor”⁸ për angazhimin dhe informimin e qytetarëve;
- Angazhimin e grupeve qytetare në fushata advokimi dhe lobimi për përmbushjen e prioriteteve të Kontratës Sociale.

Metodologjia

Për realizimin e këtij raporti, Qendra Epoka e Re, pjesë e rrjetit POP, u bazua në informacione dhe fakte të grumbulluara në tre mënyra, nëpërmjet:

- ❖ Bashkisë
- ❖ Qytetarëve
- ❖ Monitorimit




Fig. 1 Elementët ndërveprues

Për të realizuar raportin, Qendra Epoka e Re, anëtare e rrjetit POP u bazua në hapat e mëposhtëm:

⁷ <https://popnetwork.al/category/aktivitete-fier/>

⁸ <https://popnetwork.al/wp-content/uploads/2022/07/Raporti-Studimor-Bashkia-Fier-2022.pdf>

- ✈ U monitorua puna e Bashkisë Fier dhe vendimet e Këshillit Bashkiak për periudhën Shtator 2021 – Shtator 2022;
- ✈ U dërgua një letër-kërkesë me email për informacion, drejtuesve të Drejtorive dhe Departamenteve përkatëse, sipas prioriteteve të Kontratës Sociale;
- ✈ U organizuan takime me Nënkryetaren e Bashkisë znj. Enkelejda Peshkëpia, Administratorë të Njësive Administrative dhe qytetarë të Fierit, mbi ecurinë e punës sa i përket përmbushjes së prioriteteve të komunitetit;
- ✈ U realizuan fokus - grupe me anëtarë të komunitetit në 9 Njësi Administrative të Fierit dhe 4 rajonet e qytetit, me pjesëmarrës grupe të ndryshme aktive (komunitet i larmishëm), të cilët kanë qenë aktiv në aktivitetet e mëparshme dhe kanë kontribuar në përcaktimin e prioriteteve të Kontratës Sociale si edhe në monitorimin e saj gjatë vitit të parë;
- ✈ U monitorua në vazhdim puna e Këshillit Bashkiak Fier, mbledhjet e organizuara;
- ✈ U monitoruan vendimet e Këshillit të Bashkisë Fier;
- ✈ U monitoruan vendimet e Këshillit Bashkiak mbi masat e marra nga vetë bashkia, në lidhje me komunitetin në përgjithësi dhe me disa target – grupe në veçanti, si dhe veprimtaria e anëtarëve të Këshillit Bashkiak;
- ✈ U analizua dhe monitorua buxheti i bashkisë për vitin 2021 – 2022 si dhe shpenzimet respektive bazuar në open-data;
- ✈ U monitoruan dhe analizuan vendimet e KBF-së që kanë lidhje me prioritetet e Kontratës Sociale bazuar në punën e rrjetit POP, apo edhe nga faktorë të tjerë të jashtëm, të tipit:
 - ✓ Parashikime të mëhershme në buxhet;
 - ✓ Plane afatshkurtra apo/dhe afatgjata;
 - ✓ Ndikime të tjera (organizata qeveritare, organizata ndërkombëtare me projekte apo edhe kombëtare).

Hapat e ndjekur

- ✓ Përpilimi i shkresës zyrtare drejtuar Bashkisë Fier ishte hapi i parë i nisjes së procesit të formalizimit të një pune një vjeçare. Shkresa, “Kërkesë për informacion” u bazua në rezultatet e një viti më parë mbi nivelin e përmbushjeve të prioriteteve të kontratës sociale dhe u dërgua në emailin info@bashkiafier.gov.al.
- ✓ Takime të drejtëpërdrejta me përfaqësues të Bashkisë Fier për informacione specifike, krysisht për çështjen e paadresuar ende dhe ato pjesërisht të adresuara.
- ✓ Paralel me këto takime u zhvilluan edhe fokus grupet me qytetarët dhe grupet e interesit që lidhen direkt ose indirekt me përmbushjen/mospërmbushjen e prioriteteve të kontratës sociale.
- ✓ Monitorimi në vetvete u shtri në këto mënyra:
 - Monitorim i mbledhjeve të këshillit bashkiak (gjatë gjithë periudhës shtator 2021 – shtator 2022).
 - Monitorim i <http://bashkiafier.gov.al/>, faqja zyrtare e bashkisë Fier dhe FB- <https://www.facebook.com/bashkia.efierit/>.

- Monitorim faktik për çdo prioritet (gjatë periudhës së grumbullimit të informacioneve dhe takimeve me qytetarët dhe grupet e interesit).
- Monitorim i implementimit të buxhetit/buxhetit afatmesëm, PBA, etj.
- Monitorim dhe analizim i mediave audio vizive dhe on line, sipas fushave specifike. Sjellja dhe qasja e tyre.
- Monitorim dhe analizë e detajuar e buxhetit mbi eurinë buxheture të realizimit të kontratës sociale shtator 2021– shtator 2022.

Krahas monitorimit është punuar edhe në aspektin formues, nxitës dhe lobues të të rinjve:

- ✚ Organizim i të rinjve në aktivitetet vendimmarrëse, me synim përfshirjen në jetën aktive dhe të strukturuarave rinore (Këshilli Vendor Rinor).
- ✚ Lehtësimi i proceseve për informim, organizim dhe nxitje të qeverisjes vendore për të formalizuar KVR Fier.
- ✚ Organizim dhe nxitje e të rinjve për të hartuar projekte, lobuar për mbështetje financiare nga Bashkia Fier.
- ✚ Fasilitim në hartimin e 8 projekteve nga të rinjtë dhe në krijimin e mundësisë për t'i prezantuar përpara komisionit të ngritur nga Bashkia Fier, me qëllim mbështetjen financiare.

 *POP 2022 - KONTRATA SOCIALE, MJET PËR TË FORCUAR MARRËDHËNIET MES QYTETAREVE DHE PUSHTETARËVE*

Gjatë periudhës Shtator 2021 – Shtator 2022 Qendra Epoka e re, bazuar në objektivat e projektit, kishte si qëllim kryesor ndjekjen dhe nxitjen e progresit të përmbushjes së kontratës sociale. Nëpërmjet saj synonte edhe objektivave specifike si:

- Fuqizimin e ndikimit të zërit qytetar, OShC-ve për të monitoruar dhe advokuar pranë Bashkisë Fier për zbatimin e kornizës ligjore, si dhe përmbushjen e prioriteteve të kontratës sociale.
- Forcimin e rrjetit POP nëpërmjet bashkëpunimeve dhe komunikimeve të vazhdueshme për ta shtrirë impaktin edhe në bashki të tjera, jashtë territorit të veprimtarisë.
- Forcimin e marrëdhënieve midis qytetarëve, POP dhe aktorëve të tjerë në shoqëri, realizuar kjo nëpërmjet kontakteve të shumta dhe prezencës së vazhdueshme në komunitet.
- Monitorimi, raportimi dhe nxitja e drejtuesve në nivelin lokal për të përmbushur kontratën sociale në Bashkinë Fier.

Aktorët dhe target grupet e përfshira në proces:

- ✚ Bashkia Fier dhe Këshilli Bashkiak Fier;
- ✚ Kryetari i Bashkisë Fier, Kryetari i Këshillit Bashkiak Fier.
- ✚ Media dhe Organizatat e Shoqërisë Civile si aleatë në këtë proces.
- ✚ Të rinjtë, gratë, qytetarët.

Kjo nismë mbështetet nga Olof Palme International Center, me fonde të Qeverisë Suedeze si dhe nga National Endowment for Democracy.

Përmbledhje Ekzekutive

Rritja e ndikimit të qytetarëve, të rinjve, grupeve të interesit dhe forcimi i marrëdhënieve mes tyre dhe qeverisjes në nivel vendor, duke përdorur si mekanizëm bashkëpunimin, gjithashtu për përmbushjen e kontratës sociale, ka qenë fokusi i punës së projektit POP gjatë periudhës shtator 2021 – shtator 2022 në Bashkinë Fier.

- ❖ Formalizimi dhe fuqizimi i Këshillit Vendor Rinor⁹.
- ❖ Ndikim më i madh i të rinjve dhe Qendrës Epoka e Re në proceset ndërvepruese të qeverisjes vendore, duke foruar komunikimin dhe forcuar zërin e të rinjve edhe në proceset vendimmarrëse.
- ❖ Monitorim i vazhdueshëm i mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, me një qasje të re të frekuentueshmërisë së tij nga të rinj të ndryshëm jo të organizuar.
- ❖ Monitorim i punës së qeverisjes vendore në të gjithë territorin e Bashkisë për të ndjekur eurinë e përmbushjes së prioritetëve të kontratës sociale.
- ❖ Bashkëpunim, koordinim dhe ndërveprim mes Epokës së Re, të rinjve dhe qeverisjes vendore duke nxitur forcimin e marrëdhënieve mes tyre.
- ❖ Prezencë imponuese në do takim, organizim dhe konsultim që Bashkia Fier ka iniciuar gjatë periudhës shtator 2021 – shtator 2022, duke luajtur një rol aktiv në pjesëmarrje dhe nxitje të prezencës qytetare në to, me qëllim rritjen e ndërveprimit mes trinomit qytetarë – oshc – qeverisje vendore.
- ❖ Nxitje takimesh dhe organizimesh mes qytetarëve, të rinjve dhe përfaqësuesve të qeverisjes vendore (nga ana e Qendrës Epoka e Re), për të mos u mjaftuar vetëm me anagazime parimore, por edhe duke i vënë përballë angazhimeve e mosrealizimeve në formën e një llogaridhënieje që i shërben transparencës dhe përgjegjësisë institucionale për një qeverisje të mirë.
- ❖ Sigurimi i mbështetjes financiare nga Bashkia Fier për 7 projekte të ideuara dhe prezantuara nga të rinjtë e shkollave të bashkisë Fier, 2 prej të cilave në zonat rurale.

⁹ <https://ms-my.facebook.com/104337948185698/photos/a.136619568290869/323296679623156/?type=3>

Gjetjet

- Gjatë periudhës shtator 2021 – shtator 2022, Këshilli Bashkiak Fier ka marrë 122 vendime, 73 prej të cilave kanë ndikim direkt ose indirekt në përmbushjen e pikave të kontratës sociale 2019.
- Gjatë periudhës shtator 2021 – shtator 2022, mbledhjet e Këshillit Bashkiak Fier (me përjashtim të dy rasteve online), janë zhvilluar në sallën e mbledhjeve të KBF-së.
- Pas hartimit të rregullores mbi procesin e Buxhetimit me Pjesëmarrje të finalizuar një vit më parë nga Këshilli Bashkiak Fier ka qenë e dukshme prezenca e anëtarëve të këtij këshilli në konsultimet publike për “Buxhetit 2023”, "Paketes Fiskale të Vitit 2023" dhe “PBA 2023-2025”.
- Bashkia përdor gjithashtu të gjitha mënyrat për të shpërndarë njoftimet me interes publik: online, shpallje në vende me akses të gjerë dhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë.
- Mënyrat më efikase që Bashkia Fier përdor për njoftimet e qytetarëve dhe grupeve të interesit janë: Publikimet online në rrjetet sociale dhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë nëpërmjet kryeqendrës të fshatrave, administratorëve, apo njerëzve influentë.
- Shpërndarja e informacionit bëhet nëpërmjet faqes zyrtare të bashkisë¹⁰ dhe faqes zyrtare në rretin social FB¹¹.
- Kërkesë - ankesat e qytetarëve bëhen nëpërmjet: internetit në adresën zyrtare të bashkisë¹²; me shkresë nëpërmjet zyrës me një ndalesë (nëpërmjet kordinatorit të informimit); me postë/në kutinë postare (inbox) të FB-së së bashkisë.
- Qytetarët kanë shtuar rastet e shërbimit të kërkesë – ankesës në zyrën one stop shop nëpërmjet rrugës zyrtare edhe pse mbetet ende funksionale edhe mënyra online (e-mail/fb), apo takimet e drejtëpërdrejta me personat përgjegjës ose kryetarin e bashkisë.
- Është kanalizuar në një mënyrë më të strukturuar komunikimi për kërkesë informacioni nga individë apo organizata, grupe interesi duke përdorur procedurat online si një mënyrë më e shpejtë dhe formale.
- Të rinjtë – aktiv në monitorimin dhe advokimin e përmbushjes së kontratës sociale si në qytet ashtu dhe në njësi administrative.
- Formalizimi dhe funksionimi i KVR-së në Bashkinë Fier ka rritur ndikimin e tyre në proceset vendimmarrëse dhe jetën aktive.
- Të rinjtë e organizuar nga Qendra Epoka e Re bëhet faktor për sigurimin e financimit nga Bashkia Fier të 7 projekteve të realizuara dhe lobuara prej tyre.
- Janë vënë në funksion terrenet sportive pranë ETC, të cilat shërbejnë për të gjitha aktivitetet sportive të ngrupmoshave të ndryshme. Në këto ambiente zhvillohen edhe kampionatet për çdo disiplinë në nivel lokal dhe rajonal.
- Gjatë periudhës shtator 2021 – shtator 2022 është ndërhyrë në 105 godina, respektivisht: 63 shkolla; 17kopshte; 8 çerdhe; 17 institucine/qendra shëndetësore.
- Mbetet ende sfidë sigurimi i finanimi për ngritjen e një qendre pritëse psiko – sociale për gratë e dhunuara dhe fëmijët. Bashkia Fier prej vitesh ka gati projektin, si edhe

¹⁰ <http://bashkiafier.gov.al/>

¹¹ <https://www.facebook.com/bashkia.efierit/>

¹² info@bashkiafier.gov.al

alternativat për vendin e ngritjes së kësaj qendre, por ende nuk ka arritur në një mbështetje finansiare edhe në formën e bashkëfinanimit. Bashkia Fier është e gatshme të vërë në dispozicion godinën dhe stafin funksional për mbarëvajtjen e saj.

- Funksionet e Drejtorisë për Rininë, aktivitetet dhe koordinimin në Bashkinë Fier e kryen Qendra Kulturore e Fëmijëve (QKF), ku realizohen të gjithë aktivitetet për të rinjtë dhe fëmijët.
- QKF funksionon në disa sektorë (valle, letërsi, arte pamore, sporte), që merren me organizimin e aktiviteteve (pjesë e aktiviteteve të qendrës dhe pjesë e kalendarit të aktiviteteve nga Drejtorisë së Artit dhe Kulturës (DAK).

Kontratat Sociale

Nisma e rrjetit POP synon të rrisë debatin publik dhe informacionin tek qytetarët mbi platformat elektorale të partive dhe kandidatëve për kryetarë bashkie, si dhe orientimin e këtyre platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të qytetarëve. Për të arritur këtë qëllim është hartuar Kontrata Sociale për të gjitha bashkitë, ku organizatat e rrjetit operojnë, e cila është firmosur nga Kryetari i Bashkisë. Kontrata Sociale është një dokument i hartuar me prioritetet e qytetarëve nga takime, fokus grupe dhe forume të organizuara gjatë periudhës parazgjedhore 2019. Prioritetet e komunitetit bazohen në katër shtylla kryesore:

- Shërbimet Publike
- Demokracia Vendore dhe Mirëqeverisja
- Zhvillimi Ekonomik Vendor
- Dimensioni Social në Nivel Vendor

Kontratata Sociale nuk janë thjesht një premtim i shkruar, por një angazhim për kryetarët e zgjedhur për të përmbushur këto prioritete brenda katër vjeçarit të mandatit të tyre.

Kontrata sociale e Bashkisë Fier u formalizua më 17 tetor 2019, me dakortësimin/firmosjen e saj nga: Kryetari i Bashkisë Fier Z. Armando Subashi, Kryetari Këshillit Bashkiak Fier Z. Vangjel Ndreko dhe Drejtoresha Ekzekutive e Qendrës Epoka e Re Fier Znj. Nevila Jahaj¹³.

Nëpërmjet kësaj kontrate Bashkia dhe Këshilli Bashkiak angazhohen në realizimin e disa çështjeve që për komunitetin dhe kryesisht për të rinjtë janë prioritare. Kjo kontratë u firmos gjatë një Forumi Publik me pjesëmarrjen e të rinjve, shoqërisë civile, grupeve të interesit, qytetarëve e Anëtarëve të Këshillit Bashkiak Fier.


Puna për përgatitjen e saj nisi muaj më parë. Përpara përpilimit të kësaj kontrate sociale u arrit grumbullimi i mendimit dhe prioriteteve të qytetarëve/të rinjve. U realizuan disa fokus grupe dhe u studiua e gjithë situata në territorin e Bashkisë Fier, shpërndarë në problematika e shërbime reale, marrëdhëniet e ndërveprimet komunitet/të rinj, qeverisje vendore etj.

¹³ <https://popnetwork.al/wp-content/uploads/2019/06/POP-2019-Fier-Kontrata-Sociale.pdf>

Informacioni dhe rezultatet e grumbulluara nga këto zhvillime, u ndanë dhe selektuan në bazë prioritesh nga të cilat u zgjodhën po nga të rinjtë nëpërmjet procesit fokus grup, ato më të rëndësishme dhe emergjente të cilat ndikojnë në cilësinë e jetës së tyre/komunitetit.

Prioritetet e përzgjedhura nga të rinjtë/komuniteti i Fierit, janë të shtrira në 5 shtylla kryesore, si më poshtë vijon:

Rezultatet e arritura gjatë periudhës shtator 2020 – shtator 2021, të evidentuara nga montirorimi dhe specifikuar në raportin e një viti më parë, shprehen në grafikun nr: 1 që shpreh progresin e arritur.



grafiku 1 - Progresi i realizimit të prioriteteve

Situata e prioriteteve -2021 - 2022



Transparenca në menaxhinin e Njësisë së qeverisjes vendore, duke nisur nga njoftimet publike, shpërndarja e informacionit pa kërkesë dhe konsultimet publike. Ato duhet të jenë më të shpeshta, të shtrira në kohë dhe gjithëpërfshirëse;

Është rritur aksesin e të rinjve në dëgjuesat publike e në mbledhjet e Këshillit Bashkiak, por nga ana tjetër, prej disa muajsh nuk ka funksionuar faqja zyrtare e bashkisë. Për këtë arsye, progresi i këtij prioriteti duket se është stopuar. **(Adresuar Pjesërisht)**



Ndërtimi i sa më shumë terreneve sportive në qytet dhe Njësi Administrative, si dhe vënia në funksion e shkollave si qendra komunitare, kryesisht në zonat rurale. Prioritet që ka një progres edhe këtë vit, por ende qëndron në kuotat e nevojës për ndërhyrje. **(Adresuar Pjesërisht)**



Prioriteti 3

Ndërtimi i një qendre pritëse psiko-sociale për Gratë e dhunuara dhe grupet në nevojë. Pavarësisht vullnetit të bashkisë dhe përpjekjeve për çdo mënyrë bashkëpunimi, përfshirë bashkëfinancimin, përsëri mbetet një prioritet i paadresuar. Nga ana e Bashkisë Fier projekti është gati, vendi për zbatimin e tij gjithashtu është gjetur nga ana e Bashkisë por ende nuk është bërë e mundur gjetja e një financimi apo bashkëfinancimi të mundshëm. **(Nuk është adresuar)**



Prioriteti 4

Buxhet specifik për të rinjtë dhe ngritja e një strukture (Drejtorie) të vecantë në Bashki që të koordinojë marrëdhënien dhe ndërveprimin me të rinjtë.

Ky prioritet mund të klasifikohet si i adresuar për vet faktin se sot në bashki edhe pse nuk ka një drejtori që të koordinojë marrëdhëniet dhe ndërveprimet me të rinjtë ka:

- ✓ Një specialist që merret me koordinimin e marrëdhënieve dhe ndërveprimin me të rinjtë.
- ✓ Një Këshill Vendor Rinor që është formalizuar dhe është në funksion.
- ✓ Të rinj aktiv në procese vendimarrëse që njoftohen, aktivizohen rregullisht, nxiten për të qenë aktiv dhe kërkues nga qeverisja vendore.
- ✓ Buxhet për ide dhe projekte rinore dhe nisma nga të rinjtë. **(Adresuar)**



Prioriteti

Kthimi në identitet i Qendrës Kulturore të Fëmijëve, duke rikthyer gjithashtu edhe grupet e kurset e fëmijëve, të cilët sot janë të papërfaqësuar.

Ky prioritet ka progresuar dhe mund të cilësohet i adresuar. QKF ka shtuar numrin e rretheve, kurseve dhe aktiviteteve, si dhe numrin e pjesëmarrësve (fëmijëve dhe të rinjve) në to. **(Adresuar)**



Këshilli Bashkiak Fier deri në vitin 2019 kishte në përbërje të tij 41 anëtarë. Rritja e popullsisë në vitin 2018 në Bashkinë Fier, duke kaluar kufirin e 200 000 banorëve e çoi numrin e anëtarëve të Këshillit (korrik 2019) në 51. Këshilli i ri i Bashkisë Fier është konstituuar më 29 korrik 2019 ka në përbërje të tij 51 anëtarë. Mbështetur në pikën a) të nenit 54 të Ligjit nr. 139/2015 datët 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore, si dhe në Rregulloren e Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Fier, miratuar me Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 63 datë 04.09.2007, kapitulli IX neni 35, Këshilli i Bashkisë Fier në mbledhjen e datës 07.10.2019 vendosi krijimin e komisioneve të përhershme.




Fig. 1 përbërja e KBF-sw

Komisionet e përhershme¹⁴:

- Komisioni I Ekonomisë, Financës dhe Privatizimeve
- Komisioni Juridik dhe i çështjeve Institucionale
- Komisioni për Punët Publike dhe Emergjencat
- Komisioni I Çështjeve Sociale
- Komisioni për Çështjet e Zhvillimit Urban, Planifikimit të Territorit, Mjedisit dhe Shëndetit Publik.
- Komisioni I Arsimit, Kulturës, Sportit dhe i Marrëdhënieve me jashtë.
- Komisioni I Auditit.
- Komisioni I Votimit
- Komisioni për Mbikqyrjen, Kontrollin dhe Nënshkrimin e Proces – Verbaleve të Mbledhjes.
- Komisioni për Zhvillimet Bujqësore, Blegtorile dhe të Agrobiznesit.
- Komisioni për Barazinë Gjinore
- Komisioni për Shqyrtimin e Kërkesave për Shpalljen ose Njohjen e Statusit të "Dëshmorëve të Atdheut".

¹⁴ <http://bashkiafier.gov.al/>




Fig. 2. Komisionet e përhershme

Mbledhjet e Këshillit të Bashkisë Fier

Një nga elementet kryesore të POP është monitorimi i mbledhjeve dhe vendimeve që dalin nga Këshilli i Bashkisë Fier.

Gjatë periudhës shtator 2020 – shtator 2021, Këshilli Bashkiak Fier ka marrë 122 vendime, 75 prej të cilave kanë ndikim direkt ose indirekt në përmbushjen e pikave të kontratës sociale 2019.

Ndryshe nga një vit më parë, ku mbledhjet KB-së i zhvillonte përgjithësisht online, gjatë periudhës shtator 2021 – shtator 2022, pothuajse të gjitha mbledhjet, me një rast përjashtimor, janë zhvilluar në sallën e mbledhjeve të KB-së Fier.




Figure 3: Karakteri i vendimeve të KB-së Fier

Krahasuar me vitin paraardhës, edhe këtë vit tipologjia e vendimmarrjes së Këshillit të Bashkisë pothuajse ka qenë me të njëjtin orientim. Përgjithësisht vendimet kanë patur karakter social/ekonomik, më pas vijon profile i zhvillimit infrastrukturor të qytetit e në disa raste vendime me karakter të ndryshëm: arsim, sport, kulturë etj.

Nga monitorimi i vendimeve të KBF¹⁵, orientimi i ekzekutivit, bazuar në kërkesat e qytetarëve, projekteve prioritare, ndërhyrjeve të nevojshme në kohë dhe hapësirë kanë qenë të pritura në përshkallëzim nga lart poshtë në këtë mënyrë:

- ✓ 54 Vendime me karakter social, që lidhen me mbështetjen financiare për familjet në nevojë, të pastreha, ndihmë të menjëhershme në rast sëmundjeje, ndihmë për fëmijë jetim, përfshirje në shtëpinë e të moshuarve, mbrojtje civile etj.
- ✓ 22 vendime me karakter ekonomik.
- ✓ 16 vendime me karakter procedural që ndikojnë edhe në shërbime.
- ✓ 16 vendime me ndikim në Infrastrukturë e projekte prioritare.
- ✓ 3 vendime me karakter vlerësues.
- ✓ 8 vendime me karakter sportiv e arsimor (mbështetje për nxënësit).
- ✓ 3 vendime me karakter mjedisor.

Gjetje nga Bashkia Fier

Informacionet nga Bashkia Fier janë marrë nëpërmjet një shkrese zyrtare dërguar në emër të projektit POP dhe nëpërmjet takimeve të drejtëpërdrejta me secilën drejtori respektive që lidhet me progresin e pikave të kontratës sociale.

1. Transparenca

Transparencë në menaxhinin e Njesisë së qeverisjes vendore, duke nisur nga njoftimet publike. Ato duhet të jenë më të shpeshta, të shtrira në kohë dhe publike; Akses të komunitetit dhe të të rinjve në dëgjesat publike e në mbledhjet e Këshillit Bashkiak.

Edhe gjatë periudhës shtator 2022 – shtator 2022, Bashkia Fier ka vijuar përpjekjet për të rritur transparencën dhe interesin qytetar.

- Ky prioritet pothuajse ka mbetur në të njëjtin nivel me një vit më parë për një arsye thelbësore: Mosfunksionimi i faqes zyrtare (ëeb) të Bashkisë Fier. Pas kolapsit që përfshiu serverat e AKSH-it dhe problemeve teknike të mbartura, kjo faqe prej muajsh nuk funksionon më duke kthyer disa hapa pas progresin e bërë në këtë prioritet. Ka progres në aspektin e përfshirjes së të rinjve në proceset vendimarrëse dhe vullnetit të bashkisë për të qenë më afër komunitetit. Për një kohë relativisht të gjatë, disa javore nuk ka funksionuar edhe emaili zyrtar.
- Bashkia vazhdon të ndjekë të njëjtën mënyrë për të shpërndarë njoftimet me interes publik: online dhe shpallje në vende me akses të gjerë.
- Shpërndarja e informacionit bëhet nëpërmjet llogarisë institucionale në rrjetin social FB dhe deri në muajin qershor (me disa problem të mbartura) edhe nëpërmjet faqes zyrtare të bashkisë <http://bashkiafier.gov.al/>. Që nga muaji qershor kjo faqe nuk ka funksionuar dhe të gjitha njoftimet kryhen nëpërmjet FB-së së bashkisë dhe afishimeve në hapësirat e aksesueshme.
- Kërkesë - ankesat e qytetarëve bëhen në rrugë të ndryshme: nëpërmjet internetit në adresën zyrtare të bashkisë info@bashkiafier.gov.al, me shkresë nëpërmjet zyrës me një ndalesë (nëpërmjet kordinatorit të informimit), me postë, ose në kutinë postare (inbox) të FB të bashkisë.
- Rruga më e përdorshme nga qytetarët për dërgimin e një kërkesë -ankesë është online (e-mail/fb) dhe takime të drejtëpërdrejta me personat përgjegjës ose kryetarin e bashkisë.
- Pavarësisht se publikimi online i njoftimeve është më i shpejtë në shpërndarjen e informacionit, shpallja e tyre në vendet me akses të gjerë mbetet një formë e parapëlqyer nga qytetarët.
- Procesi i buxhetimit me pjesëmarrje është një nga format që qytetarët vihen përballë përfaqësuesve të qeverisjes vendore dhe diskutojnë hapur mbi probelematikat shqetësuese.
- Më 22 shtator 2022, Bashkia Fier dhe Këshilli I Bashkisë Fier ka publikuar në faqet respective të tyre në rrjetin social FB njoftimin për nisjen e konsultimeve publike në çdo njësi Administrative, duke afishuar edhe kalendarin e takimeve. Njoftimi është kryer 30 ditë përpara nisjes së takimeve konsultuese për Buxhetin dhe Paketën Fiskale për vitin 2023 dhe PBA 2023 – 2025.
- Publikimi i njoftimeve, së bashku me rendin e ditës mbi mbledhjet e këshillit bashkiak është një tjetër aspekt që nxit pjesëmarrjen dhe transparencën e

vendimmarrjes. Ai vazhdon të afishohet në faqen e Këshillit dhe Bashkisë Fier 5 ditë përpara mbledhjes së përcaktuar.

- Prania e të rinjve në mbledhjet e këshillit bashkiak tashmë ka krijuar një traditë, duke krijuar më shumë hapësirë për përgjegjshmëri, llogaridhënie dhe angazhim si nga ekzekutivi ashtu dhe nga përfaqësueset e qytetarëve (këshilltarët). Ata janë edhe pjesë e rëndësishme në takimet consultative që këshilli dhe bashkia organizojnë.

2. Infrastruktura

Ndërtimi i sa më shumë terreneve sportive në qytet dhe Njësi Administrative, si dhe vënia në funksion e shkollave si qendra komunitare, kryesisht në zonat rurale.

- ✈ Bashkia Fier gjatë periudhës Shtator 2021 – shtator 2022 ka ndërhyrë me punime të mirëmbajtjes së plotë dhe të pjesshme në të gjitha institucionet arsimore parashkollore dhe parauniversitare, duke investuar me fondet e veta në masën rreth 50 mln lekë.
- ✈ Në funksion të projektit të KOKSH-it, po investohet në 11 terrene sportive, në të gjitha Njësitë Administrative.
- ✈ Bashkia ka hartuar kalendarin e veprimtarive sportive për të gjitha grupmoshat, djem dhe vajza, ku në një vit mësimor marrin pjesë mesatarisht 5000 nxënës.
- ✈ Gjatë periudhës shtator 2021 – shtator 2022, pas shtrimit të tapetit dhe disa elementëve të tjerë të nevojshme për zhvillimin e aktivitetit fizik, terrenet sportive pranë ETC-së janë vënë në funksion. Këto ambiente sot shërbejnë për të gjitha aktivitetet sportive dhe ngrupmosha të ndryshme.
- ✈ Bashkia Fier, pas hartimit të projekteve dhe lobimit për sigurimin e mbështetjes financiare nga Qeveria, pritet të realizojë:
 - ✚ Rikonstruksionin e tre shkollave;
 - ✚ Tre terreneve sportive;
 - ✚ Ndërtimin e një shkolle të re në lagjen “Sheq i Mash”;
 - ✚ Ndërtimin e një çerdheje të re;

| Nr. | Emertimi i punimeve | Njesia | Sasia | Vlera (pa tvsh) |
|-------------------------------|--|----------------|-------|-----------------|
| VITI 2021 | | | | |
| 1 | Rruga "Kongresi i Lushnjes" L=273 ml, L. "Afrim i Ri" | m ² | 1092 | |
| 2 | Rruga "Kito Zarka" L = 274 ml, L. "Afrim i Ri" | m ² | 1096 | |
| 3 | Rruga "Shaban Serdani" L = 271 ml, L. "Afrim i Ri" | m ² | 1084 | |
| 4 | Rruga "At Isaia", L. "Afrim i Ri" | m ² | 480 | |
| 5 | Rruga "Llazi Suku" L = 200 ml, L. "1 Maj" | m ² | 800 | |
| 6 | Rruga "Pinellopi Piro", L. "29 Nentori" | m ² | 104 | 159016 |
| 7 | Rrugë në lagjen "Afrim" (intersektim me rrugën "Uan Xoxa") | m ² | 301 | |
| | | | | 159016 |
| VITI 2022¹⁶ | | | | |
| 1 | Rruga "Kujtim Majaci" L= 325 ml | m ² | 2275 | 5998100 |
| 2 | Punime për mirëmbajtjen e rrugës "Sotir Prifti", Njësia Administrative Nr:1, Fier. | m ² | 15 | 1080 |
| 3 | Rikonstruksion i rrugës "Todi Nika" me rërë bituminoze në Lagjen "Sheq i Madh", Rajoni Nr:2, Fier. | m ² | 210 | 14175 |
| 4 | Punime për sistemimin e sheshit para pallateve tek ish mapo dhe 9 katëshi, Lagjja "Apollonia". | m ² | 55 | 73590 |
| | Rruga "Novruz Pashko", lagjja "Mbrostar Ferko" | m ² | 2360 | 5665496 |
| | | | | 11752441 |

| Nr. | Objekti | Vlera |
|-------------------------------|-------------------------|------------|
| Shtator – Dhjetor 2021 | | Lek |
| 1 | Shkolla Peshtan Bregas | 28454 |
| 2 | Shkolla Pojan | 25488 |
| 3 | Kopshti 2 | 59328 |
| 4 | Shkolla Portez | 435822 |
| 5 | Shkolla Topoje | 37537 |
| 6 | Kopshti 3 me dreke | 85404 |
| 7 | Shkolla Frakull e Madhe | 78735 |
| 8 | Kopshti 6 | 66307 |
| 9 | Cerdhja 1 | 51538 |
| 10 | Cerdhja 2 | 95846 |

¹⁶ <https://docs.google.com/document/d/1bb4dikDgoXxeXbcS9m1EOMo7HIA8tdX7/edit>

| | | |
|----|--------------------------------|----------------|
| 11 | Shkolla Cakran | 140430 |
| 12 | Shkolla Andon Xoxa | 47990 |
| 13 | Shkolla Levan | 15729 |
| 14 | Shkolla Radostine | 28129 |
| 15 | Shkolla Jani Bakalli | 8410 |
| 16 | Shkolla Kraps | 536674 |
| 17 | Njesia Administrative Mbrostar | 117998 |
| 18 | Shkolla Mark Dashi | 33270 |
| 19 | Gjimnazi Janaq Kilica | 34822 |
| 20 | Shkolla Pinellopi Piro | 10479 |
| 21 | Qendra Shendetesore Mbrostar | 66631 |
| 22 | Shkolla Lalar | 176556 |
| 23 | Kopshti 5 | 76823 |
| 24 | Cerdhja 3 | 13142 |
| 25 | Shkolla Varibop | 550762 |
| 26 | Shkolla Jakov Xoxa | 22788 |
| 27 | Konvikti Ferme | 141612 |
| 28 | Ambulanca Lalar | 66138 |
| 29 | Njesia Administrative Dermenas | 97282 |
| 30 | Kopshti 4 | 45243 |
| 31 | Shkolla Kafaraj | 364667 |
| 32 | Shkolla Kreshpan | 44600 |
| 33 | Shkolla Zhupan | 284170 |
| 34 | Shkolla Naim Frasheri | 86457 |
| 35 | Cerdhja 4 | 27031 |
| | | 4002292 |

| Nr. | Objekti | Vlera |
|---------------------|--------------------------------|--------|
| Janar – Korrik 2022 | | Lek |
| 1 | Qendra Administrative Dermenas | 4830 |
| 2 | Shkolla Portez | 4806 |
| 3 | Shkolla Lalar | 7068 |
| 4 | Kopshti Portez | 760994 |
| 5 | Shkolla Vreshtaz | 5945 |
| 6 | Drejtoria e Artit dhe Kultures | 87763 |
| 7 | Shkolla Jakov Xoxa | 563806 |
| 8 | Shkolla Kristaq Shtembari | 48924 |
| 9 | Gjimnazi Janaq Kilica | 42886 |
| 10 | Shkolla Naim Frasheri | 13908 |
| 11 | Shkolla Hamil | 6974 |
| 12 | Banesa Sociale | 23022 |
| 13 | Muzeu historik | 108920 |

| | | |
|----|--------------------------------|--------|
| 14 | Kopshti nr.4 | 164672 |
| 15 | Shkolla Varibop | 768 |
| 16 | Shkolla Andon Xoxa | 95016 |
| 17 | Shkolla Jani Bakalli | 124384 |
| 18 | Cerdhja nr.2 | 20732 |
| 19 | Shkolla Jani Bocova | 19646 |
| 20 | Kopshti I Ri lagjia 15 tetori | 3816 |
| 21 | Kopshti nr.6 | 13176 |
| 22 | Qendra Shendetesore Cakran | 135551 |
| 23 | Shkolla 9 vjecare Cakran | 23437 |
| 24 | Cerdhja nr.3 | 17867 |
| 25 | Kopshti Rom | 4680 |
| 26 | Shkolla Radostine | 480 |
| 27 | Kopshti nr.5 | 128364 |
| 28 | Kopshti nr.7 | 45966 |
| 29 | Shkolla Kallm I Madh | 6529 |
| 30 | Cerdhja nr.1 | 49882 |
| 31 | Kopshti nr.2 | 4883 |
| 32 | Njesia Administrative Mbrostar | 8748 |
| 33 | Shkolla Pinellopi Piro | 2520 |
| 34 | Gjimnazi me kohe te pjesshme | 13665 |
| 35 | Shkolla Horizont | 89553 |
| 36 | Kopshti nr.3 pa ushqim | 9562 |
| 37 | Konvikti I Shkolles Bujqesore | 3000 |
| 38 | Teatri | 33400 |
| 39 | Shkolla Mark Dashi | 14092 |
| 40 | Shkolla Verri | 14479 |
| 41 | Shkolla Vajkan | 8277 |
| 42 | Kopshti nr.8 | 2784 |
| 43 | Kopshti nr. 3 me ushqim | 45947 |
| 44 | Shkolla e mesme Libofshe | 7908 |
| 45 | Shkolla Kafaraj | 5386 |
| 46 | Shkolla Kallm I Vogel | 4506 |
| 47 | Cerdhja nr.5 | 12228 |
| 48 | Shkolla Mbrostar | 20880 |
| 49 | Shkolla Peshtan Bregas | 8280 |
| 50 | Shkolla Perikli Ikonomi | 29292 |
| 51 | Njesia Administrative Libofshe | 13752 |
| 52 | Kopshti nr.8 | 6806 |
| 53 | Njesia Administrative Cakran | 33054 |
| 54 | Shkolla Zhupan | 64844 |

| | | |
|----|-------------------------|----------------|
| 55 | Shkolla Gorishove | 14929 |
| 56 | Gjimnazi Cakran | 7143 |
| 57 | Shkolla Buzemadh | 13769 |
| 58 | Shkolla Liri Gero | 17612 |
| 59 | Shkolla Liko Kostandini | 948 |
| 60 | Shkolla Kreshpan | 2928 |
| 61 | QEA | 900 |
| 62 | Bashkia Fier | 1080 |
| 63 | Shkolla Kashisht | 4800 |
| 64 | Shkolla Bishan | 7859 |
| 65 | Shkolla Sheq Musalalaj | 5511 |
| 66 | Shkolla Kraps | 8520 |
| 67 | Shkolla Ferras | 1667 |
| 68 | Shkolla Levan | 1236 |
| 69 | Shkolla Lalar | 6180 |
| 70 | Shkolla Patos Fshat | 1704 |
| | | 3089444 |

- Bashkia Fier është në proces të lidhjes së Kontratës së Dytë në vijim të Marrëveshjes Kuadër 2022: "Blerje malli për rikonstruksionin e rrugëve në bashki".
- Në këtë kontratë janë përfshirë 36 rrugë në qytet dhe në Njësi Administrative.
- Vlera e kontratës shkon në **106.000.000 lekë me T.V.SH.**
- Një pjesë e këtyre rrugëve do të mbyllet brenda vitit 2022.






Fig. 4: Shpërndarja e investimeve në institucionet arsimore, shëndetësore.

3. Shërbimet sociale

Ndërtimi i një qendre pritëse psiko-sociale për Gratë e dhunuara dhe grupet në nevojë rurale.

Bashkia Fier tashmë prej vitesh ka gati projektin për ngritjen e një qendre pritëse psiko – sociale jo vetëm për gratë e dhunuara por dhe për fëmijët. Ky projekt është lobuar dhe vijon të llobohet vazhdimisht me Ministrinë, organizata të ndryshme edhe ndërkombëtare, por nuk ka mundur të gjejë mbështetje financiare. Përveç projektit, Bashkia Fier ka gati dhe alternativat për vendin e ngritjes së kësaj qendre. Gjithashtu, ajo është e gatshme të vërë në dispozicion godinën dhe stafin funksional për mbarëvajtjen e saj, por duket se ende prioritetet e Bashkisë Fier nuk përputhen me prioritetet e organizatave apo Ministrisë, të cilat kanë qenë më shumë të fokusuar në ofrimin dhe përmirësimin e shërbimeve të ngritura më parë, apo mbështetjen e grupeve specifike si komunitetet: Rom/Egjiptian etj.

4. Vëmendje ndaj të rinjve

Buxhet specifik për të rinjtë dhe ngritja e një strukture (Drejtore) të vecantë në Bashki që të koordinojë marrëdhënien dhe ndërveprimin me të rinjtë.

- ✓ Aktualisht Bashkia e Fierit nuk ka një zyrë/drejtori të dedikuar për Rininë, por ka një specialist që merret me koordinimin e të rinjve dhe ndërveprimin e tyre me qeverisjen vendore.

- ✓ Funkcionet e kësaj drejtorie dhe realizimin e politikave të Bashkisë Fier për të rinjtë i kryen Qendra Kulturore e Fëmijëve (QKF), ku realizohen të gjithë aktivitetet për të rinjtë dhe fëmijët.
- ✓ Në Bashkinë Fier, me vendim Nr. 104 të Këshillit të Bashkisë Fier, datë 07.12. 2021 është formalizuar ngritja e Këshillit Vendor Rinor Fier.
- ✓ Në Buxhetin e Bashkisë Fier nuk ka zë të dedikuar për të Rinjtë, por nga buxheti i bashkisë janë financuar të gjitha aktivitetet për të rinjtë/fëmijët, të cilat janë organizuar nga bashkia dhe organizata për të rinjtë.
- ✓ Për herë të parë Bashkia Fier ka mirëpritur prezantimin e 8 ide-projekteve të të rinjve të shkollave të mesme në të gjithë territorin e saj, nga të cilat ka miratuar për mbështetje financiare dhe realizim 7 prej tyre.

5. Vëmendje ndaj fëmijëve

Kthimi në identitet i Qendrës Kulturore të Fëmijëve, duke rikthyer gjithashtu edhe grupet e kurset e fëmijëve, të cilët sot janë të papërfaqësuar.

QKF¹⁷ merret me organizimin e aktiviteteve (pjesë e aktiviteteve të qendrës dhe pjesë e kalendarit të aktiviteteve nga Drejtorisë së Artit dhe Kulturës (DAK), Bashkia Fier, Ajo funksionon në disa sektorë:

- ✈ Valle
- ✈ Letërsi
- ✈ Art pamor
- ✈ Sport
- ✈ Rrobaqepsi
- ✈ Aktrim
- ✈ Gazetari

Rreth 250 fëmijë e të rinj
frekuentojnë çdo javë QKF-në

Gjatë periudhës shtator 2021 – shtator 2022, aktiviteti i QKF-së është zgjeruar. Janë shtuar gjithashtu rrethet dhe kurset, dikur traditë e kësaj qendre, duke zgjuar interesin dhe rritur frekuentueshmërinë.

- Në bashkëpunim me shkollat 9 – vjeçare e të mesme, kjo qendër organizon një kalendar vjetor aktiviteteve, të cilat synojnë përfshirjen masive të nxënësve, si dhe evidentimin e vlerave më të mira të fëmijëve dhe sidomos të të rinjve të shkollave të mesme.
- Në aktivitete të ndryshme që zhvillon Bashkia marrin pjesë institucione të tjera vendore, grupe interesi dhe shoqëri civile.

¹⁷ <https://www.facebook.com/people/Qendra-e-Aktiviteteve-Kulturore-Fier/100075878440720/>

Gjatë periudhës shtator 2021 – shtator 2022, janë organizuar këto aktivitete:

- “Tetori i librit” – aktivitete me shkollat 9 vjeçare e të mesme (Tetor 2021).
- “Krosi i vjeshtës” – me shkollat 9 vjeçare e të mesme (Tetor 2021).
- Festa e 15 tetorit – koncert me këngë, valle, recitime e prezantime të ndryshme (Tetor 2021).
- Festa e Krijimit të brigadës XI sumuese (Të njohësh historinë dhe traditën) – koncert me këngë dhe recitime (Tetor 2021).
- “Kërcim dashurie” – të rinjtë e shkollave të mesme (Janar – Shkurt 2022)
- Festa e 7 marsit dhe 8 marsit – aktivitete me recitime, këngë, kërcime nga nxënës të shkollave fillore, 9 vjeçare/ të mesme dhe të ftuar personalitete veteranë të arsimit fierak (janar – mars 2022).
- “The best talents 2022” – konkurs (poezi/interpretim/prezantim; këngë/solo/në grup; valle - kërcim (valle popullore, pop, balet, kërcim modern), me pjesëmarrjen e të rinjve të shkollave të mesme nga Fieri, Patosi, Roskoveci, Ballshi, Lushnja, Divjaka. (Shkurt – Korrik 2022).
- Festa e valëve dhe gara ndërkombëtare me kuaj. (Maj – qershor 2022)
- Hiking me të rinjtë gjimnazistë shtigje të reja turistike (Vajkan – Ardenicë. Maj 2022)
- 1 Qershor si Myzeqar (Qershor 2022)
- 1 Qershori në Bibliotekë.
- Ditët verore (Qershor 2022)
- Festa e Grurit (Qershor 2022)
- 50 vjetroi i Ansambllit Myzeqeja (Qershor 2022)
- Banda Frymore – koncert (Qershor – Korrik 2022).
- Festivali Folklorik Rumani – minikoncert i QAK-së (Korrik 2022).
- Maratona e këngës (Korrik 2022)
- Festivali Ndërkombëtar Folklorik Vaslui Rumani – minikoncert i QAK-së (Gusht 2022).
- Festivali Tipologjik i Elbasanit – minikoncert i QKF-së.
- Festivali Folklorik Kombëtar i Valles Lushnje – minikoncert i QKF-së (Gusht 2022).
- Festa e miqësisë (Gusht 2022)
- Festivali Folklorik Kombëtar i Valles Berat – minikoncert i QKF-së (Shtator 2022)
- Koncert me rastin e hapjes së shkollave – koncert me këngë, valle, recitime.
- Aktivitet në nder të heroines Liri Gero – (Shtator 2022).
- Dita Kombëtare e Trashëgimisë Kulturore. (Shtator 2022)

Gjetje nga komuniteti

Krahas monitorimit të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Fier, ka vijuar monitorimi në terren dhe në kontakt të vazhdueshëm me komunitetin/grupet e interesit. Edhe pse fokusi i monitorimit ka qenë progresi i prioriteteve të kontratës sociale, janë identifikuar dhe ndjekur shqetësimet dhe problematikat e ngritura prej tyre. Përgjat muajit shtator 2022 e në vazhdim, Qendra Epoka e Re zhvilloi disa fokus grupe me qëllim trajtimin e prioriteteve të kontratës sociale. Target grupet e synuara ishin: gratë, të rinjtë, komunitet të zonave rurale, komuniteti Seman (me përfshirje të gjerë gra/të rinj) përfshirë grupet e marginalizuara, komuniteti i bashkisë qendër (qytet), të rinjtë e zonave rurale. Këto fokus grupe u shtrinë të të gjithë territorn e Bashkisë Fier, në mënyrë specifike në: 9 njësi administrative të zonave rurale dhe 4 rajonet e qytetit.

Në këto takime u diskutuan në detaje problematikat që ata mbartnin duke u ndalur edhe tek prioritetet e kontratës sociale të identifikuara 3 vite më parë. U diskutuan gjerësisht ecuria, puna e bërë ose e jo për përmbushtjen e të gjitha prioriteteve të kontratës sociale, por dhe performanca e bashkisë/shërbimeve në përgjithësi.



Transparenca

- Perceptimi qytetar në lidhje me transparencën e Bashkisë Fier për fat të keq vazhdon të mbetet i luhatshtëm. Herë ka nxitje të një përmirësimi të këtij elementi dhe herë ka një ulje drastike të tij. Përgjithësisht komuniteti është i njohur me mënyrën e njoftimeve, procedurat e kërkesë - ankesave drejtuar bashkisë, por pjesa më e madhe e tyre nuk kanë patur asnjëherë kontakt të drejtëpërdrejtë me institucionin. Ata shprehen skeptikë në lidhje me finalizimin e një procedure ankese deri në zgjidhje të saj edhe pse nuk kanë kryer asnjëherë një të tillë.
- Bashkia Fier dhe Këshilli i Bashkisë publikojnë sistematikisht njoftimet dhe zhvillimet e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak.
- Më larg këtij aksesu duket se është komuniteti në zonat rurale, i cili shfaqet më indiferent ndaj këtyre proceseve institucionale edhe pse e dinë që shumë vendimmarrje në to ndikojnë direkt në jetën e tyre.
- Komuniteti i zonave rurale nuk shprehet për transparencën institucionale pasi për ta kontakti me administratirin e NJA-së ka qenë i vazhdueshëm dhe nuk ka munguar

ndonjëherë. Kjo mjafton për të shprehur shqetësimet e tyre dhe marë informacionin që u duhet në rastet e nevojshme.

- Ndryshe shprehen banorët e 4 rajoneve të qytetit. Sipas tyre trasparenca vazhdon të jetë një “teh i mprehtë”. Sipas tyre kontakti me kryetarin e bashkisë sa vjen e zvogëlohet. Edhe pse kjo shpesh herë nga disa grupe interesi shihet si arritje për ndikimin pozitiv në shërbime dhe shpërndarje kompetencash, nga një pjesë tjetër që vazhdojnë ende ta ndiejnë të nevojshme takimin me drejtuesin e institucionit për të forcuar besimin ndaj zgjidhjes së një shqetësimi apo problemi, mbetet një element që lë shumë për të dëshiruar. Ata janë shprehur se takimet me kryetarin e bashkisë janë bërë më të rralla.
- Thelbësore mbetet aktivizimi sa më shpejt i faqes zyrtare të Bashkisë Fier ku të publikohen të gjitha informacionet në interes të opinionit public që duhet të jepet pa kërkesë, si dhe gjithcka tjetër që mund t’i vijë në ndihmë komunitetit.
- Përsa i përket mbledhjeve të KB-së, nga ana e komunitetit vazhdon të shihet një indiferencë e theksuar. Ata vihen në lëvizje për t’u bërë pjesë e tyre vetëm në rastet e një interesi personal dhe kjo është një problematikë që zbeh lidhjen qeverisje lokale – komunitet për një qeverisje më të mirë.
- Ata që duken më të interesuar për funksionimin e institucioneve dhe monitorimin e shërbimeve janë të rinjtë që janë aktivizuar në projekte dhe aktivitete të organizuara nga shoqëria civile dhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë nga Qendra Epoka e Re. numri i tyre gjatë kësaj periudhe është rritur, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ata janë organizuar në pjesëmarrje periodike të mbledhjeve të KBF-së, takime formale, konsultime publike etj.

Infrastruktura

- Përmirësimi i godinave të shkollave, terreneve sportive dhe ambienteve çlodhëse ka vijuar edhe gjatë periudhës shtator 2021 – shtator 2022, situatë e tyre vazhdon të jetë një problem evident. Prindërit, nxënësit dhe mësuesit shprehen se ka patur herë pas here ndërhyrje në godinat e shkollave, kopshteve, çerdheve, por ato janë të pamjaftueshme për të arritur standardin e nevojshëm.
- Pritja e nxënësve, prindërve dhe mësueve për zgjidhjen e situatës në shkollën “Liri Gero” dhe në shkollën “Sheq i Madh” duket se do të zgjasë edhe për pak kohë. Aktualisht ky komunitet është informuar mbi përfundimin e hartimit të projektit dhe punën e bërë nga ana e bashkisë për sigurimin e financimit, por nuk dinë ende se kur do të realizohet.
- Shqetësim për komunitetin është edhe mungesa e hapësirave rekreative kryesisht në zonat rurale. Ata janë shprehur se të gjitha ambientet e shkollave duhet të shërbejnë si qendra komunitare pas procesit mësimor, por që për fat të keq vetëm pak prej tyre, edhe këto në qytet, shërbejnë pjesërisht si të tilla, për shkak të përdorimit të terreneve sportive, apo palestrave.
- Nxënësit e shkollës së mesme në Kafaraj, Nj.A. Frakull kanë ngritur si shqetësim infrastrukturën e palestrës së shkollës së tyre, e cila pengon zhvillimin e aktivitetit fizik kryesisht në kohë të ftohtë dhe me reshje, por edhe aktivitete të tjera artistike e kulturore që shkolla organizon gjatë vitit. Pas trajnimit dhe mentorimit nga ana e Qendrës Epoka e

Re, këtë problematikë ata e prezantuan në formën e një projekti në Bashkinë Fier, duke siguruar mbështetjen financiare për zgjidhjen e këtij problemi.

➤ Shërbimet sociale

(Ndërtimi i një qendre pritëse psiko-sociale për gratë e dhunuara dhe grupet në nevojë).

Ndërtimi i një qendre pritëse psiko-sociale për gratë e dhunuara dhe grupet në nevojë është një nevojë që gjithmonë ka tërhequr vëmendjen e komunitetit kryesisht grave dhe vajzave. Ato e shohin si një nevojë të shtuar në Fier që do të ndikojë në lehtësimin e shumë situatave problemore të ndeshura shpesh kohët e fundit. Ngritja e kësaj qendre do të mundësonte që këta persona të kishin mundësi të trajtoheshin pranë rrezes së tyre të banimit, por të shkëputura nga ambienti i përditshëm. Edhe pse një nevojë imediate dhe që ka ndikim të drejtëpërdrejtë në jetën shoqërore, mbetet një prioritet që ende nuk ka marrë rrugën e zgjidhjes. Pozitive është fakti që Bashkia Fier jo vetëm e ka në prioritetet e saj, por ka bërë përpjekjet e saj për të krijuar hapësira për gjetjen e një zgjidhjeje. Ajo ka progresuar në hartimin e projektit dhe gjetjen e vendit ku mund të zbatohet ky projekt, por pavarësisht kësaj dhe lobimeve të bëra në donatorë vendas e të huaj, ende nuk është ëgjetur financimi ose bashkëfinansim, sic janë shprehur gjithmonë përfaqësuesit e Bashksië. Deri në sigurimin e këtij financimi dhe ngritjen e kësaj qendre, qytetarët kanë kërkuar bashkëpunimin e Qendrës “Epoka e Re” me institucionet lokale, për të nxitur ofrimin e programeve mbështetëse për gratë e vajzat viktime të dhunës me finalizim punësimin dhe fuqizimin ekonomik e social.

➤ Vëmendje ndaj të rinjve

- Hapat e hedhura gjatë kësaj periudhe në formalizimin dhe funksionimin e KVR-së në Bashkinë Fier e kanë bërë më prezente, kryesisht për të rinjtë informacionin mbi ligjin për rininë.
- Këshillit Vendor Rinor Fier ka dhënë ndikim pozitiv të të rinjve në organet e qeverisjes vendore. Ky organ nga ana e komunitetit shihet si një formë institucionale e rinisë për të depërtuar në disa procese që më parë kanë qenë të panjohura për ta dhe ky është një hap i madh i hedhur gjatë kësaj periudhe, duke ndikuar në nxitjen e transparencës, përgjegjshmërisë, llogaridhënies dhe qeverisjes së mirë.
- Shumë të rinj u organizuan dhe angazhuan në fushatën identifikuese të problem/ideve, kthimin e tyre në një projekt konkret me suportin dhe orientimin e qendrës “Epoka e Re”, prezantimin në bashki dhe nxitjen e mbështetjes financiare nga ana e institucionit vendor.





Vëmendje ndaj fëmijëve

- Të rinj, fëmijë, prindër dhe mësues janë shprehur të kënaqur me mënyrën e organizimit të QKF dhe fluksit të aktiviteteve që ajo zhvillon.
- QKF është kthyer në një qendër multifunkionale ku të rinjtë e fëmijët informohen, mësohen, zhvillojnë hobet e tyre, talentin dhe argëtohen.
- Zhvillimi i Qendrës Kulturore të Fëmijëve rrit vit pas viti nivelin e realizimit të këtij prioriteti.
- Rikthimi i kurseve/rretheve ishte një nevojë imediate, që bashkë me aktivitetet e larmishme që organizohen në QKF, kanë arritur të ndikojnë në cilësinë e jetës dhe zhvillimit të fëmijëve, të rinjve.

Analiza e prioriteteve

Prioritet 1: Transparenca

- Nga monitorimet e bëra gjatë periudhës shtator 2021 – shtator 2022 është e dukshme përpjekja e Bashkisë Fier për të rritur transparencën.
- Gjatë kësaj periudhe si Bashkia ashtu edhe Këshilli Bashkiak kanë qenë më të qartë dhe të vendosur për ta bërë transparencën pjesë të punës së tyre.
- Njoftimet dhe informacioni për mbledhjet e këshillit bashkiak, konsultimet publike apo takime të ndryshme me interes për qytetarët janë shpërndarë në kohe për të mos impaktuar negativisht procesin.
- Anëtarët e këshillit bashkiak kanë qenë present dhe aktiv në pothuasje të gjitha takimet ku u konsultuan: Buxheti dhe Paketa Fiskale 2023, si dhe PBA 2023 – 2025.
- KB Fier ka organizuar konsultimet publike për të gjitha aktet normative të kaluara dhe trajtuara në këshill.
- Pavarësisht ngërçit me faqen zyrtare të Bashkisë Fier, kjo e fundit është angazhuar fuqishëm për të realizuar sa më shpejt një ëeb - faqe të re, e cila do të përmbushë të gjitha kriteret dhe informacionet e nevojshme për të plotësuar nevojat e qytetarëve për informacion dhe detyrimin institucional për transparencën. Aktualisht këtë boshllëk e plotëson deri diku llogaria në rrjetin social FB përsa i përket njoftimeve dhe informimit të pjesshëm, por mbetet një vakum i madh në informacionin që duhet publikuar pa kërkesë specifike.
- Afishimi i tyre pranë zyrës me një ndalesë (one stop shop), pranë godinave të NJA-ve dhe vendeve me akses të plotë nga qytetarët, zbut disi këtë problematikë. Në nivel shumë të kënaqshëm paraqitet kthimi i përgjigjeve për kërkesë ankesat në rrugë formale (shkresore) apo online (nëpërmjet emailit), duke respektuar afatet ligjore për çdo praktikë.
- Ndryshe nga një vit më parë ku efektet e pandemisë ndiheshin ende dhe konsultimet publike për buxhetin vitit 2022 u realizuan në grupe të vogla interesi, këtë vit këto takime u realizuan në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Fier dhe me pjesëmarrje të gjerë.
- Prania e të rinjve në konsultimet publike dhe koordinimi me shoqërinë civile (Qendrën Epoka e Re) i ka bërë këto takime më të koncentruara në lidhje me problematikat e evidentuara dhe qartësinë e përcjelljes së tyre pranë përfaqësuesve të hartimit të këtyre politikave institucionale vendore.
- Progres këtij prioriteti i jep edhe hapja më e madhe e Bashkisë kundrejt komunitetit, kryesisht të rinjve. Ngritja dhe funksionimi i KVR-së ka rritur ndikimin e të rinjve dhe ka ndikuar gjithashtu edhe në rritjen e transparencës institucionale.
- Shpallja e thirrjeve të hapura për projektet rinore, pa kufizime dhe me vullnet për t'i përfshirë në buxhetimet rinore, ngre edhe më shumë nivelin e progresit të këtij prioriteti.
- Pavarësisht përpjekjeve të transparencës institucionale vijon të mbetet një prioritet që asnjëherë nuk duhet thënë plotësisht i adresuar. Ka ende shumë punë për t'u bërë që të arrijë në adresim të plotë, duke u nisur nga finalizimi i ëeb -faqe të BF-së.

- Indiferentizmi i qytetarëve në proceset vendimmarrëse dhe aktivitetin e institucionit ekzekutiv mbetet një problem evident, por përfshirja e të rinjve në këto procese duket se do të sjellë një qasje të re të komunitetit drejt këtij prioritet për ta rritur gjithnjë e më shumë nivelin e adresimit. **(pjesërisht i adresuar)**

Prioritet 2: Infrastruktura

- Angazhimi i projektit POP ka vijuar në mënyrë maksimale përsa i përket infrastrukturës në shkolla dhe kryesisht në terrenet sportive. Gjendja e rënduar e cila është trashëguar e tillë në të gjitha institucionet parashkollore, ciklin e ulët e të mesëm, ka bërë që vëmendja dhe mundësitë të jenë të kufizuara.
- Edhe pse me një numër të shtuar ndërhyrjesh në godinat arsimore gjatë kësaj periudhe, kërkohet përfshirje më e madhe e godinave arsimore në rikonstrukcion dhe krijimin e terreneve sportive, pasi në shumë prej tyre ende ndeshesh me mungesën e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor.
- Amortizimi i godinave për shkak të viteve të shumtë të kaluar pa vëmenjen minimale ndaj tyre kanë bërë që sot, pavarësisht riparimeve të shumta të mos arrihet të garantohet një infrastrukturë e pranushme për një process normal mësimor.
- Komuniteti dhe të rinjtë janë shprehur se pjesa më e madhe e godinave arsimore kanë nevojë për rikonstrukcione të plota dhe disa prej tyre për ndërtim të ri.
- Përsa i përket terreneve sportive, gjatë këtij viti janë vënë në funksion terrenet sportive pranë ETC, ku organizohen aktivitete të ndryshme sportive. Këto ambiente për shkak të konceptimit të tyre, pavarësisht se janë projektuar si ambiente sportive kanë hapësirat e nevojshme dhe kushtet që të shërbejnë edhe si qendra multifunkionale ku zhvillohen edhe aktivitete të ndryshme kulturore edukative.
- Bashkia Fier ka ndërhyrë me punime të mirëmbajtjes së plotë dhe të pjesshme në të gjitha institucionet arsimore parashkollore dhe parauniversitare, por ende nuk është arritur standardi I nevojshëm.
- Edhe këtë gjatë kësaj periudhe nuk shihet ndonjë progres në funksionimin e shkollave si qendra komunitare. Nevojitet një koordinim mes qeverisjes vendore dhe qeverisjes qendrore për të aktivizuar resurset humane dhe infrastrukturore. Nuk është vetëm mungesa infratrukturore ajo që qëngon kthimin e shkollave në qendra komunitare, por edhe mungesa e një stafi mbikqyrës.
- Aktualisht në territorin e Bashkisë Fier funksionojnë 3 (tre) qendra komunitare: Levan, Baltëz dhe Fier qytet, në pjesën më të madhe të të cilave frekuentohen nga komuniteti rom/egiptian.
- Si qendra komunitare janë përshtatur ambientet e jashtme të shkollave për ato zona ku mungon hapësira publike. Në zonat me hapësirë të mjaftueshme publike në qendër të tyre, është krijuar mundësia e një miniparku që shërben si qendër komunitare.
- Në funksion të projektit të KOKSH-it, po investohet në 11 terrene sportive, në të gjitha Njësitë Administrative.

- Bashkia ka hartuar kalendarin e veprimtarive sportive për të gjitha grupmoshat, djem dhe vajza, ku në një vit mësimor marrin pjesë mesatarisht 5000 nxënës. **(pjesërisht e adresuar)**

Prioritet 3: Shërbimet sociale

Ndërtimi i një qendre pritëse psiko-sociale për gratë e dhunuara dhe grupet në nevojë.

Kjo është një çështje e diskutuar masivisht me komunitetin, kryesisht me gratë dhe është një nevojë e mbështetur si e tillë edhe nga qeverisja vendore. Hapja e një qendre të tillë shihet si një domosdoshmëri për Bashkinë Fier si një ndër qytetit me popullsi të konsiderueshme dhe në rritje, por që mund të funksionojë edhe për bashkitë e tjera të qarkut. Bashkia Fier tashmë prej vitesh ka gati projektin për ngritjen e një qendre pritëse psiko – sociale jo vetëm për gratë e dhunuara por dhe për fëmijët. Ky projekt është lobuar dhe vijon të llobohet vazhdimisht me Ministrinë, organizata të ndryshme edhe ndërkombëtare, por nuk ka mundur të gjejë mbështetje financiare. Mesa duket prioritetet e Bashkisë Fier dhe ato të Ministrisë apo irganizamave ndërkombëtarë nuk përputhen duke e lënë zbuluar këtë kërkesë të vazhdueshme. Bashkia Fier përvec projektit ka gati dhe alternativat për vendin e ngritjes së kësaj qendre. Ajo është prehur se është e gatshme të vërë në dispozicion godinën dhe stafin funksional për mbarëvajtjen e saj. Deri tani ende nuk ka një rezultat, por përpjekjet dhe angazhimi ynë për të nxitur finalizimin e ndërtimit të saj do të vazhdojë. **(E paadresuar)**

Prioritet 4: Vëmendje ndaj të rinjve

Buxhet specifik për të rinjtë dhe ngritja e një strukture (drejtorie) të veçantë në bashki që të koordinojë marrëdhënien dhe ndërveprimin me të rinjtë.

- Ky duket se është një prioritet tashmë i përmbushur. Të rinjtë janë bërë faktor në Bashkinë Fier ku arrijnë të llobojnë, të diskutojnë, të trajtojnë problematika dhe të ndikojnë në vendimmarrje.
- Të rinjtë janë present pothuajse në cdo mbledhje të këshillit bashkiak, takime konsultative apo aktivitete të institucioneve vendore.
- Të rinjtë arrijnë të artikulojnë qartë çfarë duan dhe ta depërtojnë atë në organet vendimmarrëse nëpërmjet KVR-së.
- Bashkia Fier ka arritur të mbështesë iniciativat e të rinjve, projektet dhe idetë e tyre me grande duke hapur kështu një dritare të re bashkëpunimi. **(Adresuar)**

Prioritet 5: Vëmendje ndaj fëmijëve

- Kthimi në identitet i Qendrës Kulturore të Fëmijëve, duke rikthyer gjithashtu edhe grupet dhe kurset jashtë-shkollorë të fëmijëve, të cilët ishin të papërfaqësuar ka qenë më shumë se një prioritet i kontratës. Ky ka qenë një shqetësim i vazhdueshëm për të gjithë komunitetin kryesisht ato familje që kishin fëmijë të grupmoshës 6 – 18 vjeç.
- Deri një vit më parë kjo qendër kishte një apati dhe mungesë të larmishmërisë së aktiviteteve dhe kurseve/rretheve zhvilluese. Qëllimi I ngritjes së kësaj qendre që dikur ka qenë Shtëpia e Pionierit, më pas Qendra Kulturore e Fëmijëve angazhonte vetëm fëmijë të moshës 6-14 vjeç. Sot ka ndryshuar fokusi i kësaj qendre! Për të mos lënë jashtë vëmendjes të rinjtë, ky institucion kulturor, artistik e sportive, përfshiu në organizim edhe të rinjtë deri në moshën 18 vjeç, duke përmbushur kështu një nga pikat e prioritetit për ata që ishin të papërfaqësuar.
- Gjatë kësaj periudhe shtator 2021 – shtator 2022, kjo qendër ka vijuar zhvillimin e kurseve të munguara dhe rrethet artistike, të cilat kanë bërë që ajo të funksionojë tashmë me kapacitet thuajse të plotë. Janë hapur kurset dhe rrethet për këngë, muzikë, pikturë, kërcim, shah, sporte, letrarëve, aktrim, etj). **(Adresuar)**

Rekomandime

Prioritetet e Kontratës Sociale për Bashkinë Fier janë prioritete të nxjerra nga vet komuniteti bazuar në orientimin e të rinjve, të cilët kanë qenë promotorë të hartimit të saj. Ato janë prioritete të arsyeshme dhe me bazë ligjore të kapërcyeshme me mundësi reale përmbushjeje.

Gjatë monitorimit përgjatë periudhës shtator 2021 – shtator 2022, ka patur një ndryshim të dukshëm në qasjene Bashkisë ndaj të rinjve dhe transparencës, edhe pse është ndeshur me një ngërç teknik që ka penalizuar progresin e këtij prioriteti.

Pavarësisht vullnetit dhe angazhimit mbetet ende shumë për të bërë deri në përmbushjen e plotë të prioriteteve të dala nga qytetarët e Fierit. Qendra Epoka e Re do të vijojë monitorimin e punës së bashkisë, drejtorive përkatëse dhe vendimarrjen e Këshillit të Bashkisë.

Në vijimësi të punës, tipologjisë, angazhimit dhe mundësive që ka sot Bashkia Fier, listojmë si vijon më poshtë rekomandimet kryesore:

- Vazhdimi i rrugës së nisur me qasjen e re ndaj të rinjve dhe projekteve rinore.
- Forcimi i ndikimit të KVR-së në proceset vendimmarrëse dhe projektet e së ardhmes.
- Nxitja e këtij modeli edhe tek komuniteti dhe grupet e interesit për të rritur besimin e qytetarëve tek qeverisja vendore.
- Prezantimi sa më parë i faqes së re zyrtare (WEB) të Bashkisë Fier, e cila do të afrojë edhe më shumë interesin qytetar, të rinjtë dhe grupet e interesit të informohen rreth shërbimeve, punës dhe projekteve të ardhme të Bashkisë. Kjo do të krijojë një lidhje

organike mes tyre, ku nëpërmjet nxitjes së qeverisjes së mirë që do të ndikojë në rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe jetës.

- Duke qenë ende në punim, sugjerojmë që Web – faqe të jetë e thjeshtë në format, me informacionet e nevojshme dhe lehtësisht të kuptueshme dhe aksesueshëm nga të gjithë qytetarët.
- Prezenca e shtuar e të rinjve dhe ndikimi i tyre në procese të rëndësishme të vendimmarrjes lokale duhet të vazhdojë të rritet, pasi vetëm në këtë mënyrë do të mund të nxisim interesin qytetar dhe përgjegjësinë institucionale.
- Edhe pse puna e Epokës së Re ka arritur të krijojë rekorde positive të dukshme, duhet të vazhdojë të fokusohet në nxitjen e sa më shumë kontakteve, konsultimeve, takimeve të bashkisë me komunitetin, me të rinjtë, si dhe në krijimin e mundësive për zhvillim e organizim të tyre.
- Më shumë fonde për institucionet arsimore, kryesisht për ndërhyrje të thella e jo pjesshme, pasi në këtë mënyrë asnjëherë nuk do të arrihet rezultati i pritshëm.
- Shtimi i terreneve sportive në ambientet publike jashtë territorit të shkollave, si mundësi të hapura për të gjithë anëtarët e komunitetit që nuk mund të frekuentojë këto ambiente.
- Të shtrihet lobimi për gjetje fondesh për ndërtimin e qendrës psiko – sociale në disa donatorë apo bashkëfinancues të mundshëm, duke përfshirë edhe biznesin vendas.
- Vënia në funksion e shkollave edhe si qendra komunitare.

Aneke

Aneks 1 Mbledhjet e Këshillit Bashkiak

| Nr. | Nr. vendim | Subjekti i vendimit | Data |
|-----|------------|---|------------|
| 1. | 82 | Për rishpërndarje të fondeve në buxhetin e bashkisë Fier për vitin 2021. | 22.10.2021 |
| 2. | 83 | Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtezuar 6% për muajin shtator 2021. | |
| 3. | 84 | Për miratimin e planit rrugor për pasaportën me nr.205, kodi nr.11286. | |
| 4. | 85 | Për miratimin e shtesës së numrit të punonjësve të bashkisë Fier. | |
| 5. | 86 | Për miratimin e planit rrugor për pasaportën me nr.101 kodi nr.1/192. | |
| 6. | 87 | Për miratimin e planit rrugor për pasaportën me nr.1463, kodi nr.9/74. | |
| 7. | 88 | Për një shtese në vkb nr.75, datë 14.09.2021 "Për miratimin e ndryshimeve në vlerën e subvencionit të qirasë dhe skualifikimin e familjeve të pastreha përfituese nga programi i subvencionit të qirasë në tregun e lirë, miratuar me vkb nr.11, datë 02.03.2021" | |
| 8. | 89 | Për miratimin e kërkesës së familjes së pastrehë E. M. për këmbim banese sociale me qira. | |
| 9. | 90 | Për pranim në shtëpinë e të moshuarve Fier. | |
| 10. | 91 | Për një shtesë në vendimin "Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të bashkisë Fier. | |
| 11. | 96 | Për miratimin e buxhetit të bashkisë. | 7.12.2021 |
| 12. | 97 | Për shqyrtimin e vendimit të komisionit të prokurimit publik me nr.774/2021 datë 18.10.2021 | |
| 13. | 98 | Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm vendor (pba) 2022-2024 të bashkisë Fier dhe miratimin e kalendarit të hartimit të PBA 2023-2025 | |
| 14. | 99 | Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të bashkisë Fier. | |
| 15. | 100 | Për një shtesë në vkb nr.11, datë 02.03.2021 për shtimin e listës së familjeve të pastreha që kanë aplikuar për tu trajtuar me një nga programet sociale të strehimit", shtuar me vkb nr.45, datë 29.06.2021 "Për një shtesë në vkb nr.11, datë 02.03.2021 për shtimin e listës së familjeve të pastreha që kanë aplikuar për tu trajtuar me një nga programet sociale të strehimit dhe miratimin e listës emerore të familjeve të pastreha që përfitojnë nga programi social i subvencionimit të interesave të kredisë". | |
| 16. | 101 | Për miratimin e familjes së pastrehe në nevojë A. A. për t'u strehuar në banesat sociale me qira, pronë e bashkisë Fier, banesë sociale e cila rezulton e lirë nga menaxhimi i banesave sociale me qira. | |
| 17. | 102 | Për miratimin e përfundimit të procedurave të privatizimit të banesave që kanë mbetur pa u regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, të kontratave para noterit. | |
| 18. | 103 | Për skualifikimin e familjeve të pastreha përfituese nga programi i subvencionit të qirasë në tregun e lirë, miratuar me vkb nr.11, datë 02.03.2021. | |

| | | | |
|-----|-----|---|------------|
| 19. | 104 | Për miratimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë, si dhe mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij. | |
| 20. | 105 | Për miratimin e koordinatorit dhe personit mbështetës për programin "Romacted". | |
| 21. | 106 | Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis Këshillit të Europës, zyra në Tiranë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Bashkisë Fier, për implementimin e programit "Romacted". | |
| 22. | 107 | Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Fier, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës ekonomike për familjen e shtetasit I.G. fshati Frakull e Vogël, njësia administrative Frakull, i dëmtuar nga zjarri i datës 19.10.2021, nga buxheti i Bashkisë Fier, programi "mbrojtja civile". | |
| 23. | 108 | Për miratimin e listës së familjeve në nevojë që do të përfitojnë subvencionin me rastin e festave të fundvitit 2021. | |
| 24. | 109 | Për miratimin e procedurës për nxjerrjen pjesërisht jashtë funksionit për sipërfaqen 66m ² ne pasurinë vendstrehim me numër inventari 770 me sipërfaqe totale 123 m ² , referuar shkresës së ministrisë së mbrojtjes nr.1972 prot dt.28.03.2019 dhe me urdhër nr.229 dt.21.05.2021 të kryetarit të Bashkisë Fier, sipas gjendjes faktike pasqyruar në procesverbal, referuar shkresës së Ministrisë së Mbrojtjes. | |
| 25. | 110 | Për miratimin e procedurës për nxjerrjen jashtë funksionit për pasurinë vendstrehim ndodhur në lagjen "16 Prilli", pronë e Bashkisë Fier, me numër inventari 769, me sipërfaqe 94m ² sipas planshetës 79-87 dhe gjendjes faktike, pasqyruar në procesverbalin, planvendosje, referuar shkresës së Ministrisë së Mbrojtjes | |
| 26. | 111 | Për ndarjen e natyrës së sipërqafes takuese të ndërtimit të ri në pasurinë me nr 6/534 mzk 8531. | |
| 27. | 112 | Për miratimin e dhënies me qira të objektit lokal, pjesë e objektit "Tregu produkteve bujqësore dhe blektorale" me sipërfaqe 248.87 m ² , në përgjegjësi të administrimit të Bashkisë Fier, nëpërmjet procedurës së konkurimit. | |
| 28. | 113 | Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin nëntor 2021. | 21.12.2021 |
| 29. | 114 | Për një shtesë në buxhetin e Bashkisë Fier për vitin 2021. | |
| 30. | 115 | Për miratimin e bursave për nxënësit që ndjekin programet mësimore, pranë shkollave profesionale për vitin arsimor 2021-2022. | |
| 31. | 116 | Për miratimim ndihme. | |
| 32. | 117 | Për miratimin e planit të aktiviteteve të Këshillit Bashkiak Fier për periudhën janar-dhjetor 2022. | |
| 33. | 1 | Për emërtim rruge. | 05.01.2022 |
| 34. | 2 | Për një ndryshim ne vendimin nr. 915, datë 11.11.2015 të Këshillit të Ministrave, "Për transferimin në pronësi nga Këshillat e Qarqeve të bashkitë, të rrjetit të rrugëve rurale dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të ndërmarrjeve të mirëmbajtjes së këtyre rrugëve", të ndryshuar, si dhe për transferimin në pronësi të Bashkisë fier, të një pjese të pasurisë 3/656, zona kadastrale 8532". | |

| | | | |
|-----|----|--|------------|
| 35. | 3 | Për miratimin e kërkesë së familjes /individit të pastrehë në nevojë R.SH. për strehim në banesat sociale me qira, pronë të Bashkisë Fier, si dhe të kërkesës së familjes së shtetasës M.M, e strehuar në banesat sociale, për ndihmë në faljen e detyrimeve të prapambetura. | 31.01.2022 |
| 36. | 4 | Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirase dhe miratimin e vlerës mesatare të qirasë në tregun e lirë, për efekt të llogaritjes së masës së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij për vitin 2022. | |
| 37. | 5 | Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin social të strehimit, subvencionimin e qirase në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij. | |
| 38. | 6 | Për miratimin e subvencionit të qirasë për familjet e pastreha, që banojnë me qira në tregun e lirë dhe nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për ta përballuar vetë gjithë vlerën e qirasë. | |
| 39. | 7 | Për miratimin e listës emërore të familjeve të pastreha që kanë aplikuar për t'u trajtuar me një nga programet sociale të strehimit. | |
| 40. | 8 | Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Fier, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjen e shtetasit S.B, lagjia "Apollonia", njësia administrative nr.4, i dëmtuar nga zjarri i datës 29.11.2021, nga buxheti i Bashkisë Fier, programi "mbrojtja civile". | |
| 41. | 9 | Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Fier, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjen e shtetasit F.S, lagjia "Kastriot", njësia administrative nr.4 për demet e pësuar në banesën (ku jeton si qiraxhi), nga zjarri i datës 16.12.2021, nga buxheti i Bashkisë Fier, programi "mbrojtja civile". | |
| 42. | 10 | Për trajtimin me ndihmë financiare të familjeve të fshatrave Ferras e erven te njesive levan e Frakull të dëmtuara nga përmbytja e lumit Vjosë në datën 12.12.2021. | |
| 43. | 11 | Për pranim në shtëpinë e të moshuarve Fier. | |
| 44. | 12 | Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën me fondet e pushtetit qendror e vendor për vitin 2022. | |
| 45. | 13 | Për dhënien e një ndihme financiare për shpenzime varrimi për dy familje. | |
| 46. | 14 | Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin dhjetor 2021. | |
| 47. | 15 | Për shtesën e të ardhurave të trashëguara të buxhetit të Bashkisë Fier për vitin 2022. | |
| 48. | 16 | Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Fier". | |

| | | | |
|-----|----|--|------------|
| 49. | 17 | Për dhënien e titullit "Nderi i Bashkisë Fier" për ekipin e basketbollit për femra "Apollonia", të viteve 1970-1985 me motivacionin: Për kontributin e jashtëzakonshëm që i ka dhënë ndër vite sportit fierak, zhvillimin e sportit të femrave dhe ndihmesën e madhe të dhënë në komunitet për emancipimin e grave". | |
| 50. | 18 | Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin janar 2022. | 28.02.2022 |
| 51. | 19 | Për pranim në shtëpinë e të moshuarve Fier. | 07.03.2022 |
| 52. | 20 | Për miratimin e raportit vjetor të zbatimit dhe monitorimit të buxhetit 2021. | |
| 53. | 21 | Për rishpërndarje të fondeve në buxhetin e Bashkisë Fier për vitin 2022. | |
| 54. | 22 | Për miratimin e përfundimit të procedurave të privatizimit të banesave të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kdastrës, Drejtoria Vendore Fier, të kontratave para noterit. | |
| 55. | 23 | Për autorizimin e Bashkisë Fier të nënshkruajë marrëveshjen me AGA Solarpark sh.p.k. | |
| 56. | 24 | Për miratimin e raportit për vlerësimin dhe parashikimin afatmesëm të të ardhurave 2023-2025. | |
| 57. | 25 | Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të buxhetit afat mesëm (PBA) 2023-2025 të Bashkisë Fier. | |
| 58. | 26 | Për pranimin në shtëpinë e të moshuarve Fier. | 30.03.2022 |
| 59. | 27 | Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin shkurt 2022. | |
| 60. | 28 | Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin mars 2022. | 28.04.2022 |
| 61. | 29 | Për miratimin e financimit të shumës përkatëse të tvsh për mallrat, shërbimet, ndërtimet dhe pajisjet që do të përfitohen nga projekti me UNDP Albania. | |
| 62. | 30 | Për miratim projekti prioritar i Bashkisë Fier. | |
| 63. | 31 | Për një ndryshim në vendimin eKëshillit të Bashkisë nr 96 datë 07.12.2021 "Për miratimin e buxhetit të bashkisë për vitin 2022". | |
| 64. | 32 | Për miratimin e rregullores së brendshme të klubit shumësportesh "Apollonia" sh. a". | |
| 65. | 33 | Për ndryshim të vkb-së nr.62, datë 06.08.2021 si dhe dhënien e pëlqimit për transferimin e të drejtës së zhvillimit dhe të ndërtimit, të lejes së ndërtimit miratuar me vendim nr.40, datë 08.03.2022, sipas vkm-së nr.408, datë 13.05.2015 | |

| | | | |
|-----|----|--|------------|
| 66. | 34 | Për disa shtesa dhe ndryshime në vkb-në nr.95, datë 07.12.2021, "Mbi strukturën dhe nivelin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2022". | |
| 67. | 35 | Për miratimin e planit të masave "Për parandalimin dhe mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri". Ky plan masash synon të parandalojë dhe të mbrojë një sipërfaqe prej 7062 ha dhe kullota që shtrihen brenda territorit administrativ të Bashkisë Fier. | |
| 68. | 36 | Për miratim ndihme. | |
| 69. | 37 | Për dhënien e ndihmes ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin prill 2022. | 23.05.2022 |
| 70. | 38 | Për pranim në shtëpinë e të moshuarve Fier. | |
| 71. | 39 | Për dhënien e një ambjenti pa qira tek ish-shtëpia e officerëve Fier për implementimin e një projekti rajonal të UNDP-Komisionit Europian "forcimi i sistemeve kombëtare dhe lokale për të mbështetur integrimin efektiv socio-ekonomike të të rikthyerve në Ballkanin Perendimor". | |
| 72. | 40 | Për miratimin e marrëveshjes së bashkive të qarkut Fier dhe "Integrated Technology Waste Treatment Fier" sh.p.k. | |
| 73. | 41 | Për një ndryshim në vendimin nr 76 datë 27.09.2016 të Këshillit të Bashkisë Fier "Për kategorizimin e niveleve të përfaqësimit të nxënësve dhe studentëve në olimpiadat kombëtare dhe ndërkombëtare, në maturën shtetërore, çmime të tjera dhe përcaktimi i masës së shpërblimit të tyre". | |
| 74. | 42 | Për miratimin e pasqyrave financiare të sh.a. Ujësjetës Kanalizime Fier për vitin 2021. | |
| 75. | 43 | Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin e Këshillit të Bashkisë Fier nr. 35, datë 20.06.2020, "Për shpronësim për interes publik, te pasurisë së paluajtshme pronë private, që preket nga realizimi i projektit për rehabilitimin e lumit Gjanicë, rikonceptimi i qendrës së qytetit dhe ndërtimi i pallatit të sportit të lojërave me dorë, Fier. | |
| 76. | 44 | Për shpronësim të pjesshëm, për interes publik, të pasurisë së paluajtshme pronë private, qe preket nga realizimi i projektit "Rikonstruksioni i rrugës Tasi Dema", njësia administrative nr. 1, Bashkia Fier. | |
| 77. | 45 | Për një ndryshim dhe shtesë në vendimet e KBF nr.64, datë 25.09.2020 dhe nr.68, datë. 14.09.2021, "Për shpronësim për interes publik, të pasurisë së paluajtshme pronë private, që preket nga realizimi i projektit "Për rehabilitimin e lumit Gjanicë, faza e 2-të, nga segmenti i Urës me Shkallë deri tek Ura e Sheqit, Fier". | |
| 78. | 46 | Për miratimin e financimit të projektit "79 tour of Albania". | |
| 79. | 47 | Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin social të strehimit subvencionim i interesave të kredisë. | |
| 80. | 48 | Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.25 datë 16.04.2021. | |

| | | | |
|-----|----|---|------------|
| 81. | 49 | Për një shtesë në vkb nr.7 datë 31.01.2022 për shtimin e listës së familjeve të pastreha që kanë aplikuar për tu trajnuar me një nga programet sociale të strehimit. | |
| 82. | 50 | Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Fier së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjen e shtetasit R.M, fshati "Çlirim" njësia administrative Qendër, i dëmtuar nga zjarri i datës 02.04.2022, nga buxheti i Bashkisë Fier, programi "mbrojtja civile". | |
| 83. | 51 | Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Fier së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjen e shtetasit Q.F, lagjia "16Prilli", njësia administrative nr.4 për demet e pësuar në banesën e tij, nga zjarri i datës 25.04.2022, nga buxheti i Bashkisë Fier, programi "mbrojtja civile". | |
| 84. | 52 | Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Fier së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjen e shtetasit Xh.B. fshati Hoxharë, njësia administrative Dërmënas për demet e pësuar në banesën e tij, nga zjarri i datës 8.04.2022, nga buxheti i Bashkisë Fier, programi "mbrojtja civile". | |
| 85. | 53 | Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Fier së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjen e shtetasit Th. K, lagja "Liri Gero", njësia administrative nr.2 për demet e pësuar në banesën e tij, nga zjarri i datës 10.04.2022, nga buxheti i Bashkisë Fier, programi "mbrojtja civile". | |
| 86. | 54 | Për përcaktimin e procedurës për negociimin me zhvilluesit privat që shprehin interesin që të bashkëpunojnë me Bashkinë e Fierit nëpërmjet marrëveshjes për pronat kufitare të cilat bashkohen për qëllime zhvillimi. | 8.06.2022 |
| 87. | 55 | Për miratimin e pasqyrave financiare të sh.a. klubit shumësportësh Apollonia Fier për vitin 2021. | |
| 88. | 56 | Për një shtesë në vkb nr.66, datë.25/09/2017 të Këshillit të Bashkisë Fer "Për miratimin dhe zbatimin e projekteve të Bashkisë Fier", materializuar me vkm nr.31, datë. 17/01/2018 "Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga realizimi projektit "Për rehabilitimin e lumit Gjanicë, Fier". | |
| 89. | 57 | Për pjesëmarrjen e Bashkisë Fier në subjekte me kompetenca të përbashkëta me qëllim kryerjen e sërëbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura. | |
| 90. | 58 | Për miratim projekti prioritar i Bashkisë Fier. | |
| 91. | 59 | Për miratimin e financimit të shpenzimeve të transportit të pacientëve, banorë të Bashkisë Fier që kurohen me kimioterapi në Tiranë. | |
| 92. | 60 | Për miratimin e financimit të disa shpenzimeve të kampionatit kombëtar të volejbollit që do të zhvillohet në Tiranë midis bashkive. | |
| 93. | 61 | Për miratimin e fillimit të procedurës për prishjen e objektit vendstrehim pronë e BF me vendim të Këshillit të Ministrave nr 375 datë 18.05.2011 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shteterore që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Libofshë, të qarkut të Fierit ", pasuria me nr.14/4 zk.2443 fshati Libofshë nj.a. Libofshë, sipas planimetrisë së | 15.06.2022 |

| | | | |
|------|----|---|----------------------|
| | | objekteve që do prishen nga zbatimi i projektit "Rikualifikimi i qendrës së fshatit Libofshë" | |
| 94. | 62 | Për miratimin e pagesës së shpenzimeve të varrimit të znj. B.S. | |
| 95. | 63 | Për miratim pagese qiraje banese. | |
| 96. | 64 | Për miratim ndihme ekonomike. | |
| 97. | 66 | Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin maj 2022. | 27.06.2022 Online |
| 98. | 67 | Për dhenien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin qershor 2022. | 22.07.2022 |
| 99. | 68 | Për pranim në shtëpinë e të moshuarve Fier. | |
| 100. | 69 | Për miratimin e tavaneve përfundimtare dhe projekt dokumentin e programit buxhetor afat mesem (PBA) 2023-2025 të Bashkisë Fier). | |
| 101. | 70 | Për miratimin e ndryshimeve në vlerën e subvencionit të qirasë dhe skualifikimin e familjeve të pastreha përfituese nga programi i subvencionit të qirasë në tregun e lirë, miratuar me vkb nr.6, datë 31.01.2022. | 08.08.2022 |
| 102. | 71 | Për shpërndarjen dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar për emergjencat civile për vitin 2022. | |
| 103. | 72 | Për miratimin e kërkesës së bashkisë Fier, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjen e shtetasit Murat Ferko, lagjia "Mbrostar Ferko", njësia administrative nr.3, për dëmet e pësuar në banesën e tij, nga zjarri i datës 18.05.2022, nga buxheti i bashkisë Fier, programi "mbrojtja civile". | |
| 104. | 73 | Për rritjen e numrit të punonjësve të MZSh | |
| 105. | 74 | Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.96 datë 07.12.2021 "Për miratimin e buxhetit të bashkisë për vitin 2022". | |
| 106. | 75 | Për emërtim rruge. | |
| 107. | 76 | Për një ndryshim të vendimit të KBF nr. 9, dt. 27.01.2017. | |
| 108. | 77 | Për miratimin për shfrytëzim për grumbullimin dhe groposjen e kadavrave të kafshëve në cdo njësi administrative. | |
| 109. | 78 | Për miratimin e marrëveshjes dhe pjesëmarrjen e bashkisë në subjekte me kompetenca të përbashketa me qëllim kryerjen e shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura. | |
| 110. | 79 | Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin korrik 2022. | |

| | | | |
|------|----|--|------------|
| 111. | 80 | Për pranim në shtëpinë e të moshuarve Fier. | |
| 112. | 81 | Për dhënien e autorizimit, Kryetarit të Bashkisë Fier për fillimin e procedurave të negociimit me Bashkitë e Qarkut Fier, për realizimin e procedurave të marrjes në dorëzim, sipas detyrimeve të kontratës për ndërtimin dhe administrimin e Impiantit të Trajtimit të Mbetjeve Urbane në Qarkun Fier, në Bashkitë e Qarkut Fier. | 27.09.2022 |
| 113. | 82 | Për një shtesë në Buxhetin e Bashkisë Fier viti 2022 | |
| 114. | 83 | Për trajtimin me ndihmë financiare të familjes së shtetasit Astrit Metua, fshati Mbrostar, NjA Mbrostar, për dëmet e pësuar në banesën e tij nga zjarri i datës 16.05.2022. | |
| 115. | 84 | Për miratimin e vazhdimin të procedurës për ndryshimin e kategorisë së tokës së pafrytshme në tokë bujqësore, Nr. Pas 9/10, ZK 3358 Sheq Marinas, NjA Topojë. | |
| 116. | 85 | Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Nr. 96 datë 07.12.2021, Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Fier për vitin 2022. | |
| 117. | 86 | Për dhënien në përdorim pa kundërshtim të sipërfaqes prej 150 m ² të objektit ish zyrat e Rajonit nr. 2 ZK 8532, pronë e Bashkisë Fier, Njësisë së Kujdesit Shëndetësor, Fier. | |
| 118. | 87 | Për fillimin e procedurave të marrjes në përdorim të përkohshëm, nga shoqëria SPV Blue 1, të pasurive ku do të vendosen shtyllat e linjës së transmetimit të tensionit. | |
| 119. | 88 | Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin Gusht 2022. | |
| 120. | 89 | Për miratimin e Dokumentit Buxhetor afat mesëm 2023-2025. | |
| 121. | 90 | Për plotësim Vakance në Këshillin e Bashkisë Fier. | |
| 122. | 91 | Për pagesën e shpenzimeve të transportit të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit të tyre. | |
| | | Informacion në lidhje me kërkesën e paraqitur "Shprehje interesi për zhvillimin e pronave në pronësi të Bashkisë Fier". | |
| | | Informacion në lidhje me raportin e monitorimit 8 mujori 2022. | |

Aneks 2 - Referenca

- Faqja zyrtare e Bashkisë Fier <http://bashkiafier.gov.al/sq-al/Pages/default.aspx>
- FB Bashkia Fier <https://ëëë.facebook.com/bashkia.efierit/>
- <http://bashkiafier.gov.al/sq-al/Bashkia/Pages/Nioftime.aspx>
- <http://bashkiafier.gov.al/sq-al/Services/Pages/Kerkese-Ankese.aspx>
- <http://bashkiafier.gov.al/sq-al/Services/Pages/Programi-i-transparences-.aspx>
- <http://bashkiafier.gov.al/sq-al/Services/Pages/E-drejta-p%C3%ABr-informimit.aspx>
- <http://bashkiafier.gov.al/sq-al/Services/Pages/Regjistri-K%C3%ABrkes%C3%AB-P%C3%ABrgjigje.aspx>
- Faqja e Këshillit të Bashkisë Fier <http://bashkiafier.gov.al/sq-al/Keshilli/Pages/default.aspx>
- FB e Këshillit të Bashkisë Fier <https://ëëë.facebook.com/pages/category/Not-a-Business/K%C3%ABshilli-Bashkiak-Fier-104337948185698/>
- Kontrata Sociale <https://popnetëork.al/raporti-nje-vjecar-kontrata-sociale-bashkia-fier/>
- Kontrata Sociale Fier viti I parë I monitorimit <https://popnetëork.al/kontrata-sociale-fier-permbushja-e-prioriteteve-viti-i-pare-i-monitorimit/>
- Raporti studimor mbi pjesëmarrjen dhe angazhimin qytetar në nivel vendor <https://popnetëork.al/raporti-studimor-pjesemarrja-dhe-angazhimi-qytetar-ne-nivel-vendor-fier/>
- Vendimet e KB Fier <https://popnetëork.al/shkurt-21-vendimet-e-keshillit-bashkiak-fier/>
- Prezantimi I Kontratës Sociale <https://popnetëork.al/prezantimi-i-raportit-nje-vjecar-kontrata-sociale-pop-bashkia-fier/>
- Takime me komunitetin <https://popnetëork.al/takime-me-komunitetin-e-bashkise-fier/>
- Forumi publik <https://popnetëork.al/forumi-publik-pop-2019-fier/>
- Raporti mbi Covid-19, Bashkia Fier [Raporti Bashkia Fier COVID-19](#)

Aneksi 3 - Kontrata Sociale

